

# STUDIM MBI ÇËSHTJET MJEDISORE RAJONI VERI-PERËNDIMOR





# Fuqizimi i organizatave të shoqërisë civile për mbrojtjen e mjedisit në Shqipëri

---

Studim tematik mbi çështjet mjedisore në rajonin veriperëndimor

**VIS Albania**  
*Volontariato Internazionale per lo Sviluppo*  
**Vullnetarizmi Ndërkombëtar për Zhvillim**

Shtator 2023

Publikuar nga:  
VIS Albania

Adresa: Rruga "Don Bosko", pallati Grapshi, 2/4/2,  
Tirana, Shqipëri  
Zyra lokale: Koplík Qendër,  
Malësi e Madhe, Shqipëri

Web: [www.volint.it](http://www.volint.it)

Email: [vis.albania@volint.it](mailto:vis.albania@volint.it)

Projekti: "Fuqizimi i organizatave të shoqërisë civile për mbrojtjen e mjedisit në Shqipëri"

Autorë:

**Dr. Brikenë Dionizi**  
**Anna Carboni**  
**Sonila Kocli**  
**Martina Dedaj**

Lektore, Universiteti i Shkodrës "Luigj Gurakuqi"  
Përfaqësuese ligjore e VIS në Shqipëri  
Koordinatorë rajonale e VIS në Shqipëri  
Agjente e zhvillimit lokal e VIS në Shqipëri

Redaktoi: **Ana Zhibaj**

## Shënim

"Ky dokument është hartuar në kuadër të projektit Green-AL, një projekt i financuar nga Agjencia Ndërkombëtare Suedeze për Bashkëpunim dhe Zhvillim (Sida), me fondet e Qeverisë Suedeze. Mendimet dhe pikëpamjet e shprehura në të i përkasin autorëve dhe nuk pasqyrojnë me domosdoshmëri pikëpamjet e donatorit".

## TABELA E PËRMBAJTJES

<b>1. RRETH GREEN-AL</b> .....	<b>6</b>
2.1 TË DHËNA GJEOGRAFIKE DHE ADMINISTRATIVE.....	10
2.2 BURIME NATYRORE.....	12
2.3 ASPEKTI SOCIAL-EKONOMIK .....	14
2.4 TË DHËNA DEMOGRAFIKE .....	15
<b>3. GRUPET E PËRFSHIRA TË INTERESIT (STAKEHOLDERS)</b> .....	<b>16</b>
3.1 GRUPET E PËRFSHIRA TË INTERESIT (STAKEHOLDERS) SIPAS PROJEKTEVE SPECIFIKE .....	21
<b>4. PROJEKTE TË ZBATUARA</b> .....	<b>25</b>
4.1 PROJEKTI: PËRMIRËSIMI I IMAZHIT TË VENDIT PËRMES AKTIVITETEVE MJEDISORE NË BAJZË - HANI I HOTIT (MALËSI E MADHE) .....	25
.....	25
4.1.1 SFONDI I ÇËSHTJES.....	25
4.1.2 PËRSHKRIMI I ÇËSHTJES SË TRAJTUAR .....	29
4.1.3 PËRFUNDIME.....	33
4.1.4 SUGJERIME .....	34
4.2 PROJEKTI: PASTRIMI I MJEDISIT TË LIQENIT TË SHKODRËS NGA RRJETAT E BRAKTISURA.....	35
4.2.1 SFONDI I ÇËSHTJES.....	35
4.2.2 PËRSHKRIMI I ÇËSHTJES SË TRAJTUAR .....	39
4.2.3 PËRFUNDIME.....	43
4.2.4 SUGJERIME .....	44
4.3 PROJEKTI: TË RINJTË SHKODRANË KUNDËR HUMBJEVE USHQIMORE .....	44
4.3.1 SFONDI I ÇËSHTJES.....	44
4.3.2 Përshkrimi i çështjes së trajtuar.....	46
4.3.3 PËRFUNDIME.....	49
4.3.4 GJETJE NGA BASHKIA SHKODËR .....	50
4.3.5 GJETJE NGA TREGJET E FRUTA-PERIMEVE TË ZONËS SË SHKODRËS.....	50
4.3.6 GJETJE NGA TOKA LABORATOR .....	51
4.3.7 SUGJERIME .....	51
4.4 PROJEKTI: LËVIZJA RINORE-QYTETI IM EKOLOGJIK .....	53
4.4.1 SFONDI I ÇËSHTJES.....	53
4.4.2 PËRSHKRIMI I ÇËSHTJES SË TRAJTUAR .....	57
4.4.3 PËRFUNDIME.....	68
4.4.4 SUGJERIME .....	68
<b>5. PËRFUNDIME</b> .....	<b>69</b>
<b>REFERENCA</b> .....	<b>73</b>
<b>ANEKS</b> .....	<b>75</b>
PËRMBLEDHJE E INFORMACIONEVE PËR SHOQATAT QË KANË ZBATUAR PROJEKTET .....	75
1. SHOQATA BLINI .....	75
2. ORGANIZATA E MENAXHIMIT TË PESHKIMIT (OMP) LIQENI I SHKODRËS .....	75
3. WELL-POINT – KUJDES PËR TË GJITHË .....	76

4. FORUMI SHQIPTAR LIQENI I SHKODRËS (FSLs) .....	77
---	----

## LISTA E TABELAVE

Tabela 1. Grupet e interesit të përfshirë në projektet zbatuese .....	17
Tabela 2. Përmbledhje e projektit "Blini" .....	22
Tabela 3. Përmbledhës projekti "OMP" .....	22
Tabela 4. Përmbledhje e projektit të "Well-Point" .....	23
Tabela 5. Përmbledhës projekti "FSLs" .....	24

## LISTA E GRAFIKËVE

Grafik 1. Gjinia e përfituesve të drejtpërdrejtë në rajon.....	19
Grafik 2. Grupet e interesit ( <i>stakeholders</i> ) të përfshirë në projektet zbatuese .....	19
Grafik 3. Takimet e realizuara në zbatim të projekteve .....	20
Grafik 4. Pyetësi online (shpërndarja).....	58
Grafik 5. Pyetësi në terren (shpërndarja) .....	58
Grafik 6. Sa njohuri keni për Qytetin Ekologjik? .....	60
Grafik 7. Njohuritë për konceptet.....	60
Grafik 8. Njohuritë që kanë të anketuarit për përfitimet nga hapësirat e gjelbra apo shërbimet e komunitetit .....	61
Grafik 9. Përpjekjet e të anketuarve për të kursyer energji në shtëpi (të anketuarit në terren) .....	61
Grafik 10. Përpjekjet e të anketuarve për të kursyer energji në shtëpi (të anketuarit online) .....	62
Grafik 11. Shpërndarja gjeografike e kampionit të intervistuar që ka termoizolim (pyetësi në terren) .....	62
Grafik 12. Shpërndarja gjeografike e kampionit të intervistuar që ka termoizolim (pyetësi online).....	63
Grafik 13. A ka hapësira të bollshme rekreative të gjera? .....	63

## LISTA E FIGURAVE

Figura 1. Ndarja territoriale e vendit për qëllime menaxheriale të Green-AL.....	8
Figura 2. Rajoni veriperëndimor sipas bashkive .....	9
Figura 3. Qarku Shkodër sipas bashkive.....	10
Figura 4. Qarku Lezhë sipas bashkive.....	11
Figura 5. Qarku Shkodër .....	12
Figura 6. Qarku Lezhë .....	14
Figura 7. Bashkia Malësi e Madhe .....	25
Figura 8. Bashkia Malësi e Madhe sipas njësisve administrative .....	27

Figura 9. Pamje nga Syri i Sheganit .....	28
Figura 10. Takimi hapës i projektit .....	29
Figura 11. Trajnimi dhe pastrimi i mbetjeve në bashkëpunim me nxënësit e shkollës 9-vjeçare "Prekë Gjoni" në Bajzë.....	30
Figura 12. Foto nga shenjimi i shtegut në monumentet e natyrës "Hordhanat e Virit" dhe "Syri i Sheganit" .....	31
Figura 13. Vendosja e koshave dhe përmirësimi i mjedisit të jashtëm pranë gjimnazit "Dodë Kaçaj" në Bajzë.....	32
Figura 14. Pamje nga Liqeni i Shkodrës.....	35
Figura 15. Rrjeti i Zonave të Mbrojtura dhe Parku Natyror "Liqeni i Shkodrës" .....	36
Figura 16. Pozicionimi i Liqenit të Shkodrës në Rajon .....	37
Figura 17. Trajnimet me peshkatarët .....	40
Figura 18. Trajnime me nxënësit e shkollave 9-vjeçare në Shirokë & Bajzë, Malësi e Madhe .....	40
Figura 19. Procesi i pastrimit nga rrjetat e braktisura .....	41
Figura 20. Peshkimi si burim kryesor të ardhurash për familjet.....	42
Figura 21. Pamje nga aktivitetet e projektit .....	46
Figura 22. Pamje nga trajnimi për mbetjet ushqimore.....	47
Figura 23. Voza rrotulluese.....	48
Figura 24. Vizita në landfillin e Bushatit .....	49
Figura 25. Piramida ushqimore.....	52
Figura 26. Bashkia Shkodër sipas njësive administrative .....	54
Figura 27. Pamje e qytetit të Shkodrës.....	55
Figura 28. Pika interesi për Shkodrën të rëndësishme për zhvillimin lokal .....	55
Figura 29. Rajoni i Liqenit të Shkodrës .....	56
Figura 30. Lëvizja Rinore-Qyteti im Ekologjik.....	57
Figura 31. Takimi prezantues në nivel rajoni .....	58
Figura 32. Pamje nga anketimi qytetar .....	59
Figura 33. Shpërndarja e analizës studimore .....	65
Figura 34. Aktiviteti Një parcelë-Një emër.....	65
Figura 35. Pamje nga aktivitetet e Panairi i Ideve-Qyteti im Ekologjik .....	66
Figura 36. Panairi i Ideve-Qyteti im Ekologjik.....	66
Figura 37. Pamje nga aktivitetet e projektit FSLs .....	67

**LISTA E SHKURTIMEVE**

<b>AdZM</b>	Administrata Rajonale e Zonave të Mbrojtura
<b>AKZM</b>	Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura
<b>AZHR</b>	Agjencia e Zhvillimit Rajonal
<b>DAR</b>	Drejtoria Arsimore Rajonale
<b>DShPA</b>	Drejtoria e Shërbimit të Peshkimit dhe Akua-kulturës
<b>FAO</b>	<i>Food and Agriculture Organization of the United Nations</i> (Organizata e Kombeve të Bashkuara për Ushqimin e Bujqësinë)
<b>FSLs</b>	Forumi Shqiptar Liqeni i Shkodrës
<b>INSTAT</b>	Instituti i Statistikave
<b>NJA</b>	Njësi Administrative
<b>OMP</b>	Organizata e Menaxhimit të Peshkimit, Liqeni i Shkodrës
<b>OSHC</b>	Organizata të Shoqërisë Civile
<b>OZHQ</b>	Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm
<b>PBB</b>	Produkti i Brendshëm Bruto
<b>PGM</b>	Pikat e Grumbullimit të Mbetjeve
<b>Well-Point</b>	<i>Well-Point</i> , Kujdes për të gjithë
<b>ZVA</b>	Zyra Vendore Arsimore



## 1. RRETH GREEN-AL

Projekti "Fuqizimi i organizatave të shoqërisë civile për mbrojtjen e mjedisit në Shqipëri", Green-AL, janar 2021 – dhjetor 2023, zbatohet nga Co-PLAN, Instituti për Zhvillimin e Habitatit, në bashkëpunim me CISP, *Comitato Internazionale per lo Sviluppo dei Popoli*; VIS Albania, *Volontariato Internazionale per lo Sviluppo*; COSV, *Coordinamento delle Organizzazioni per il Servizio Volontario, (Partneriteti)*. Green-AL është një projekt i financuar nga Agjencia Ndërkombëtare Suedeze për Bashkëpunim dhe Zhvillim (Sida), me fondet e Qeverisë Suedeze.

Projekti ka pasur për qëllim të japë kontribut në forcimin e kapaciteteve të OSHC-ve mjedisore dhe krijimin e mundësive të reja për bashkëpunim ndërmjet OSHC-ve, organizatave me bazë lokale, autoriteteve publike në nivel lokal e kombëtar, institucioneve arsimore, bizneseve dhe komunitetit duke synuar krijimin e urave të bashkëpunimit ndërmjet grupeve të interesit për të ngritur e trajtuar çështje mjedisore në nivel lokal, rajonal e kombëtar. Për të arritur këtë qëllim, projekti ka pasur këto objektiva:

- 1- Hartimi dhe zbatimi i një strategjie për të rritur kapacitetet e OSHC-ve mjedisore në vend;
- 2- Prezantimi i modeleve novatore në menaxhimin e mjedisit përmes një skeme gjithëpërfshirëse të nën-granteve;
- 3- Faktorizimi i kontributit të OSHC-ve mjedisore dhe rolit të advokimit në proceset e hartimit të politikave mjedisore.

Për të siguruar një menaxhim të mirë të projektit dhe një mbështetje të vazhdueshme organizatave mjedisore në Shqipëri, partnerët e projektit, për çështje menaxhimi, kanë vendosur të 'ndajnë' territorin e vendit në 4 rajone kryesore. Secili nga partnerët ka qenë përgjegjës për të ofruar asistencë dhe mentorim OSHC-ve të cilat operojnë në rajonin përkatës. Partnerët e Green-AL kanë një eksperiencë të gjatë në hartimin dhe zbatimin e projekteve mjedisore si dhe në mbështetjen e OSHC-ve në nivel lokal e kombëtar.

### **Rajoni qendror**

**Co-PLAN, Instituti për Zhvillimin e Habitatit** është një organizatë jo-fitimprurëse me një përvojë të gjatë dhe një portofol të gjerë kërkimi në fushën e ofrimit të shërbimeve publike, zhvillimit rajonal, planifikimin urban, menaxhimin e mjedisit, forcimit të kapaciteteve të OSHC-ve dhe punonjësve të administratës publike, kërkimit në politika e çështje ndër-sektoriale dhe advokimit në proceset politikë-bërëse. Co-PLAN, pozicionohet midis aktorëve me ndikim, me përvojë, të mirë-formuar të Shoqërisë Civile në Shqipëri, me mbi 200 projekte zhvillimi të zbatuara, e angazhuar që nga viti 1995 për ngritjen e advokimit për çështjet mjedisore nëpërmjet dialogut sistematik me institucionet në nivel kombëtar e lokal duke ndërmarrë nisma të ndryshme për rritjen e ndërgjegjësimit të grupeve të interesit lidhur me mjedisin.

## Rajoni veriperëndimor

**Volontariato Internazionale per lo Sviluppo, VIS Albania/Vullnetarizmi Ndërkombëtar për Zhvillim** është i pranishëm në Shqipëri që nga viti 1995, me hapjen e vendit ndaj pjesës tjetër të botës. VIS Albania është një degë e *International VIS* me seli në Romë, Itali. VIS Albania është pjesë e një rrjeti ndërkombëtar të OJQ-ve nga Spanja, Gjermania, Belgjika dhe Austria dhe ka qenë e vazhdon të jetë e pranishme me projekte zhvillimi në 50 vende të botës, në të gjitha kontinentet. Në kuadër të ndërgjegjësimit botëror për çështjet mjedisore, krahas arsimit, VIS po orientohet gjithnjë e më shumë në zbatimin e projekteve që synojnë ruajtjen e biodiversitetit (Amerika e Jugut) dhe zhvillimin rural (Afrikë dhe Ballkan).

## Rajoni verilindor

**Comitato Internazionale per lo Sviluppo dei Popoli, CISP/Komiteti Ndërkombëtar për Zhvillimin e Popujve** është një organizatë jo-qeveritare europiane (OJQ) e krijuar në vitin 1982 dhe e themeluar zyrtarisht në 1983. Ajo është e vendosur në Itali dhe vepron në fushën e bashkëpunimit ndërkombëtar. CISP punon në Shqipëri që nga viti 1998. Në nivel sektorial, gjatë viteve të para të pranisë së saj në Shqipëri, CISP ka realizuar aktivitete me qëllim ndihmën humanitare dhe fushata informuese në nivel kombëtar në çështjet sociale dhe mjekësore. Kohët e fundit, një sektor i ri i ndërhyrjes është zhvillimi urban dhe menaxhimi i territorit, si dhe mbrojtja e mjedisit, duke përfshirë menaxhimin e mbetjeve, ndërgjegjësimin dhe informacionin për çështjet mjedisore në tërësi.

## Rajoni jugor

**Coordinamento delle Organizzazioni per il Servizio Volontario, COSV/Koordinimi i Organizatave të Shërbimit Vullnetar** është një shoqatë jo-fitimprurëse e themeluar në vitin 1968, e angazhuar në zhvillim dhe ndërhyrje humanitare në Europë, Ballkan, Afrikën Jugore dhe Lindjen e Mesme. COSV operon për paqen, respektimin e të drejtave të njeriut dhe mbrojtjen e mjedisit, përmes shtigjeve gjithëpërfshirëse të zhvillimit të ndërtuara mbi qasjen e partneritetit dhe rrjetëzimit, për të përmirësuar rrethanat lokale dhe për të krijuar një ndikim të provuar e afatgjatë. Puna jonë është e frymëzuar nga "kultura e bashkëpunimit" e kuptuar si solidaritet midis komuniteteve dhe është e orientuar në rindërtimin e kapitalit vendas dhe në vendosjen, përmes komuniteteve dhe në to, të marrëdhënieve të forta, për të mbështetur transformimet e rëndësishme politike dhe ekonomike në themel të zhvillimit.

Figura 2: Ndarja territoriale e vendit për qëllime menaxheriale të Green-AL




Green AL, përgjatë 2+ viteve të zbatimit të tij, ka arritur të mbështesë në mënyrë të drejtpërdrejtë nëpërmjet skemave të granteve më shumë se 50 OSHC, me një shumë totale prej rreth 800,000 euro, që iu dha organizatave aplikante. Në thirrjet për projekt propozime të dy skemave të granteve të hapura në Green-AL, OSHC-të mjedisore kanë aplikuar me rreth 103 projekt-propozime nga të cilat 31 aplikime janë shpallur fituese, duke arritur të zbatojnë projektet e tyre në 25 bashki të vendit e trajtuar çështje të cilat shqetësojnë komunitetet e vogla lokale deri tek çështjet mjedisore në nivel kombëtar si ndryshimet klimatike, mbrojtja e natyrës, dhe ndotja.

Partnerët e Green-AL në bashkëpunim me organizatat përfituese të granteve kanë organizuar [5 Forume Kombëtare](#) me qëllim advokimin për çështjet mjedisore të cilat shqetësojnë komunitetet dhe janë me rëndësi kombëtare. Gjithashtu, këto organizata kanë ofruar gatishmërinë e tyre për të bashkëpunuar në proceset e përafrimit të legjislacionit, në kuadër të hapjes së negociatave për anëtarësimin e vendit në Bashkimin Europian, me fokus kryesor Kapitullin 27: Mjedisi.

Burimi: Përpunuar nga autorët

Figura 2. Rajoni veriperëndimor sipas bashkive



Në rajonin veriperëndimor, që përfshin qarqet Shkodër dhe Lezhë, në kuadër të skemës së granteve të Iniciativës dhe Partneritetit, janë zbatuar 4 projekte nëpërmjet angazhimit të katër organizatave lokale: shoqata Blini, Organizata e Menaxhimit të Peshkimit (OMP) Liqeni i Shkodrës, *Well-Point* (Kujdes për të gjithë) dhe Forumi Shqiptar Liqeni i Shkodrës (FSL). 3 kanë qenë bashkitë në të cilat këto nisma mjedisore kanë marrë jetë, përkatësisht: bashkia Shkodër, Malësi e Madhe dhe Lezhë. Angazhimi i shoqatave lokale u bë me qëllim që ndërhyrjet të ishin efektive, të qëndrueshme dhe në linjë me nevojat e komuniteteve lokale. Këto shoqata kanë vepruar në drejtim të ndërgjegjësimit të komuniteteve lokale për rëndësinë që ka mjedisi për jetën ekonomike dhe sociale, pastrimit të mjedisit dhe fuqizimin e komuniteteve lokale nëpërmjet zhvillimit të trajnimeve, për përdorimin e mjedisit në funksion të jetës së tyre të tashme e të ardhme (me këndvështrim Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm). Temat e trajtuara kanë pasur në fokus mbrojtjen dhe promovimin e burimeve natyrore, konservimin e biodiversitetit, menaxhimin e mbetjeve, si edhe promovimin dhe zhvillimin e eko-turizmit.

Burimi: Përpunuar nga autorët


## 2. SFONDI RAJONAL

### 2.1 TË DHËNA GJEOGRAFIKE DHE ADMINISTRATIVE

Ndarja administrative dhe tokësore ka pësuar ndryshime të konsiderueshme pas ndryshimeve politiko-ekonomike të Shqipërisë në vitin 1990. Që në atë kohë, ndarja administrative-territoriale ka pësuar tre ndryshime rrënjësore, si nga përbërja strukturore, po ashtu edhe nga ajo funksionale e njërive administrative. Ndryshime të tilla, relativisht të shpeshta, mund të ndikojnë në çorientimin e komuniteteve lokale, duke i shkaktuar një ndjenjë copëzimi. Gjithashtu, për shkak të këtyre ndryshimeve, qasja që këto komunitete

kanë në burime, infrastrukturë e fonde ka ndryshuar.

Figura 3. Qarku Shkodër sipas bashkive



Në vitin 2015 u miratuan me ligj rajonet zhvillimore dhe, me Vendim të Këshillit të Ministrave, u miratua krijimi i Agjencisë Kombëtare për Zhvillim Rajonal, Agjencive të Zhvillimit Rajonal (AZHR) dhe Agjencisë së Zhvillimit Ekonomik Rajonal. Me vendim nr. 961, datë 02.12.2015 "Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e Agjencisë Kombëtare për Zhvillim Rajonal, të Agjencive të Zhvillimit Rajonal dhe Agjencisë së Zhvillimit Ekonomik Rajonal" Shqipëria ndahet në katër rajone zhvillimore.

Në këtë studim janë përfshirë qarqet Shkodër dhe Lezhë, të cilët, së bashku me qarkun Kukës, bëjnë pjesë në AZHR1. Qarku Shkodër është një nga 12 qarqet e Republikës së Shqipërisë dhe një nga më të mëdhenjtë, me një sipërfaqe 3,562 km<sup>2</sup>. Ai shtrihet nga Alpet në veri deri në ultësirën bregdetare, duke u kufizuar në veri me Malin e Zi, në jug me qarkun Lezhë, në lindje më qarkun Kukës dhe në perëndim me detin Adriatik. Ka një vijë kufitare 304 km, ku 149 km janë me

Malin e Zi. Sipas ndarjes administrativo-territoriale qarku Shkodër ka në përbërje të tij 5 bashki.


Qarku Lezhë shtrihet mes fushës pjellore të Zadrimës në veri, maleve Pukë-Mirditë në lindje, bregut të Matës (krijuar nga prurjet e lumit Drin dhe Mat) në jug, dhe bregdetit të Adriatikut në perëndim, me një shtirje 1588.4km<sup>2</sup>. Qarku Lezhë kufizohet në veri me qarkun Shkodër, në verilindje me qarkun Kukës, në lindje dhe juglindje me qarkun Dibër, në jug me qarkun Durrës dhe në perëndim me detin Adriatik me vijë bregdetare 38 km të gjatë (nga Rëra e Hedhur deri te Kepi i Rodonit). Sipas ndarjes administrativo-territoriale, qarku Lezhë ka në përbërje të tij 3 bashki.

Figura 4. Qarku Lezhë sipas bashkive



Sipas ndarjes administrativo-territoriale, duke iu referuar ligjit nr. 115/2014 dhe ligjit nr. 31/2021, qarku i Shkodrës përfshin 5 bashki: bashkia Shkodër (me 11 njësi administrative në përbërje të tij), bashkia Vau i Dejës (me 6 njësi administrative) bashkia Malësi e Madhe (me 6 njësi administrative), bashkia Pukë (me 5 njësi administrative) dhe bashkia Fushë Arrëz (me 5 njësi administrative). Ndërkohë, qarku Lezhë përfshin 3 bashki: bashkia Lezhë (me 10 njësi administrative), bashkia Kurbin (me 4 njësi administrative), bashkia Mirditë (me 7 njësi administrative).

**Legjendë**

 Bashki Qarku Lezhë

## 2.2 BURIME NATYRORE

Rajoni veriperëndimor përfshin një zonë me burime të pasura natyrore ku mund të përmendim:

- **Pyjet e dendura**, të cilat përbëjnë një burim të rëndësishëm natyror. Ato sigurojnë lëndë drusore për komunitetet lokale, habitat për kafshët e egra dhe mundësi çlodhjeje për vizitorët e banorët. Megjithatë, shpërdorimi prej vitesh i këtij burimi kaq të rëndësishëm ka shkaktuar degradim mjedisor. Në këtë rast kihet në vëmendje OzhQ15: Jeta në tokë.

Figura 5. Qarku Shkodër



- **Burimet e pasura ujore**, ku pjesë e kësaj zone janë liqenet, lumenjtë e detet. Përmendim veçanërisht lumin Drin (lumi më i gjatë në Shqipëri) dhe liqenin e Shkodrës. Këto burime duhet të ruhen e të mirëmbahen. Në këtë rasti kihet në vëmendje OZhQ14: Jeta nën ujë.

- **Bujqësinë**, ku toka pjellore e zonës mund të shërbejë mjaft mirë për mbjelljen e një numri të madh kulturash, duke krijuar kështu mundësi të aplikimit të praktikave të bujqësisë së qëndrueshme për një zhvillim ekonomik të qëndrueshëm të kësaj zone.

- **Bukuritë natyrore** në zonë (male, lumenj, liqene e det) bëjnë të mundur që ky rajon të jetë një destinacion turistik mjaft interesant, duke bërë kështu që turizmi të jetë i rëndësishëm për sigurimin e të ardhurave të komuniteteve lokale. Megjithatë, rritja e turizmit mund të shkaktojë një degradim mjedisor, ndotje e shkatërrim të habitatit, shterim të burimeve natyrore e humbje të biodiversitetit. Prandaj, është e domosdoshme që të sigurohen sa më shpejt praktika të zhvillimit të qëndrueshëm në zonë e të balancohet zhvillimi ekonomik me mbrojtjen e burimeve natyrore dhe promovimin e qëndrueshmërisë sociale e kulturore.

Qarku Shkodër është i njohur për burime të pasura hidrografie duke qenë se në territorin e tij shtrihen lumenjtë Drini, Buna,

Shala, Kiri, Ceni, si edhe përrenj të tjerë dhe burime ujore. Në përfundim ndodhet liqeni i Shkodrës, liqeni më i madh në Ballkan me sipërfaqe 368 km<sup>2</sup>, prej ku 169 km<sup>2</sup> i përket territorit shqiptar dhe pjesa tjetër Malit të Zi. Liqeni përfaqëson rrjetin më të madh të ujërave të ëmbla në Mesdhe dhe një florë e faunë shumë të pasur. Liqeni është një burim vlerash klimaterike. Klima e tij është shumë e shëndetshme dhe përbën një mundësi mjaft të lartë për zhvillimin e turizmit. Zona e Velipojës, e ndodhur buzë detit Adriatik, vetëm 36 km larg nga qyteti i Shkodrës, është një nga perlat e natyrës shqiptare ku gërshetohen në mënyrë harmonike deti, lumi, mali, ishulli, laguna, dhe pylli. Plazhi i Velipojës ka një gjatësi prej 14 km dhe shtrihet nga delta e Bunës deri në rrëzë të malit Maja e Zezë. Vlen për t'u përmendur Parku i Alpeve, i shpallur si i fillë me vendim të Këshillit të Ministrave nr. 59, datë 26.01.2022. Në këtë park përfshihen ekosistemet natyrore Lugina e Valbonës, Thethi, (i shpallur Park Kombëtar, kategoria II) dhe lumi i Gashit, (shpallur Rezervë Strikte Natyrore, kategoria I). Të gjitha këto burime natyrore mbulojnë një sipërfaqe prej 82,844 ha (AKZM, 2023a). Thethi ndodhet në pjesën veriore të njësisë administrative të Shalës dhe rrethohet nga malet e Alpeve Shqiptare me lartësi deri 2,559 m. Thethi ka 70 burime uji me cilësi e pastërti të lartë, me florë dhe faunë shumë të pasur dhe është një pikë turistike e rëndësishme në Shqipëri.

Në Parkun Natyror Bashkiak të Shkrelit (rreth 10 km në verilindje të qytetit të Koplikut, Malësi e Madhe) gjendet Reçi, një nga 3 fshatrat kryesorë të këtij parku. Me gështenjat e moçme shekullore (të cilat janë shpallur monument natyre me pemë me moshë mesatare 300-vjeçare) dhe me mundësitë e ofruara për aktivitete në natyrë, vendi është kthyer në një pikë kryesore për turizmin familjar.

Zonat natyrore veçanërisht të mbrojtura, të përfshira në listën e konventës "Ramsar" janë zona e lumit Bunë, ishulli i Franc Jozefit, rezervati Velipojë, plazhi i Baks-Rrjollit, kënetat e Domnit dhe liqeni i Shkodrës. Ky i fundit është peizazh ujor e tokësor i mbrojtur<sup>1</sup> (Shkodër, 2014).

---

<sup>1</sup> <https://akzm.gov.al/zonat-e-mbrojtura/>



Figura 6. Qarku Lezhë



Qarku i Lezhës ndodhet në kryqëzimin e të gjitha arterieve të transportit, duke shërbyer si urë lidhëse veri-jug e lindje-perëndim. Territori është i pasur me pasuri mbi e nëntokësore, hidrike, minerare, etj. dhe ka kushte të favorshme për gjallesën e një shumëllojshmërie të florës e faunës tokësore dhe ujore, të egra e të buta, duke siguruar vlera të larta shkencore, biologjike e ekologjike.

Në qarkun e Lezhës ndodhen monumentet natyrës Berzanë, Kunë Vain-Tale, Patok-Fushëkuqe-Ishëm, dhe Peizazhi i Mbrojtur Bjeshkët e Oroshit (rrethi Mirditë). Me pasuritë e tij natyrore, Qarku Lezhë ka mundësi shumë të mëdha për turizëm lagunor, turizëm luginor e turizëm kulturor. Plazhet e shumta ranore që ofron, të shoqëruara me bukuri natyrore e veti kurative, e bëjnë këtë qark shumë tërheqës për turizëm, ku në disa periudha të vitit popullsia rritet në mënyrë të konsiderueshme. Turizmi përbën një burim ekonomik për komunitetet lokale, por prirja drejt përfitimeve ekonomike afatshkurtra përbën jo rrallë një kërcënim për zhvillimin e qëndrueshëm në vend. Ndërgjegjësimi, fuqizimi e përfshirja e komuniteteve në vendimmarrje është një ndërhyrje e domosdoshme në zonë.

## 2.3 ASPEKTI SOCIAL-EKONOMIK

Rajoni veriperëndimor me pasuritë e tij të shumta natyrore përbën një atraksion turistik të rëndësishëm gjatë gjithë vitit. Zona bregdetare, shumë e parapëlqyer gjatë periudhës maj-shtator, ka një dyndje të turistëve nga të gjitha vendet. Gjithashtu, turizmi malor është shumë i parapëlqyer për qëllime çlodhëse, kulturore e edukative.

Elementët fiziko-gjeografikë të territorit, të gërshetuar me njëri-tjetrin, florën dhe faunën, dhurojnë peizazhe e bukuri mahnitëse që nxisin kryesisht zhvillimin e agro-biznesit dhe turizmit. Komunitetet lokale shfrytëzojnë burimet natyrore në zonat e tyre për të siguruar jetesën. Kështu:

- **prania e tokave pjellore** në zonë siguron një mundësi për zhvillimin e bujqësisë (në qarkun Shkodër në 11,661 ndërmarrje aktive, 47.2% janë ferma; ndërkohë që në qarkun Lezhë në 5,540 në total, 25.5% e tyre janë ferma (INSTAT, 2022).
- **pasuritë natyrore** sigurojnë mundësi për zhvillimin e turizmit (në qarkun Shkodër 9.4% e numrit total të ndërmarrjeve janë struktura akomoduese, duke e bërë kështu qarkun e tretë në Republikën e Shqipërisë me numrin më të madh të strukturave akomoduese në vlerë absolute, ndërsa për sa i përket qarkut Lezhë 14% e numrit total të bizneseve janë struktura akomoduese (INSTAT, 2022).
- **pasuritë ujore** shërbejnë si burim jetese për komunitetet lokale nëpërmjet peshkimit.

Të gjitha sa më sipër paraqesin një panoramë të përgjithshme të rajonit duke nxjerrë në pah rëndësinë që ka mjedisi për zhvillimin socio-ekonomik të komuniteteve lokale, por edhe për të gjithë vendin, duke pasur parasysh që turizmi është një nga fushat që kanë përparësi dhe një sektor strategjik për Shqipërinë.

## 2.4 TË DHËNA DEMOGRAFIKE

Rajoni veriperëndimor, ashtu si i gjithë vendi, përballet me një lëvizje të konsiderueshme të popullsisë. I gjithë rajoni ka një migrim të brendshëm negativ (vlen të përmendet që përveç qarkut Tiranë dhe Durrës, të gjithë qarqet e tjera në Republikën e Shqipërisë kanë koeficient bruto negativ për migracionin e brendshëm neto).

Më konkretisht, qarku i Shkodrës ka një popullsi prej 198,009 banorë, me një shkallë natyrore rritje me -3 për 1,000 banorë dhe shkallë migrimi të brendshëm neto me -7.1 për 1,000 banorë, me vlerën më të lartë të migrimit të brendshëm neto negativ në bashkinë Fushë Arrëz (INSTAT, 2022).

Qarku Lezhë ka një popullsi prej 117,283 banorë, me një shkallë rritje natyrore me -0.4 për 1.000 banorë dhe shkalla e migrimit të brendshëm me -11.1 për 1.000 banorë, me vlerën më të lartë të migrimit të brendshëm neto negativ në bashkinë Mirditë (INSTAT, 2022).

Por, migrimi i brendshëm neto negativ në të gjithë rajonin ka shkaktuar tkurrje të popullsisë. Kjo vërehet sidomos në zonat e thella malore, por edhe në zona rurale, duke ndikuar kështu normalisht në forcën punëtore. Prandaj, fuqizimi i këtyre komuniteteve, ndërgjegjësimi për potencialet që kanë zonat e tyre përkatëse, do siguronte një motiv më tepër për ta që të qëndrojnë e të japin kontribut në vendet e tyre.

Në qytetin e Shkodrës gjendet gjithashtu Universiteti "Luigj Gurakuqi". I hapur në vitin 1957 si Institut i Lartë Pedagogjik (ka marrë statusin e Universitetit me vendim të Këshillit të Ministrave nr. 167 datë 28.05.1991), ky institucion ka bërë ndryshime rrënjësore gjatë jetës së tij mëse 65-vjeçare. Aktualisht, institucioni i vetëm i arsimit të lartë për veriun e Shqipërisë ofron më tepër se 30 programe studimi në gjashtë fakultetet e tij. Ai përbën një qendër shumë të rëndësishme edukimi e fuqizimi për të gjithë komunitetin lokal të rajonit veriperëndimor nëpërmjet integritit të elementeve mjedisore, planifikimit të territorit, modeleve të qëndrueshme të biznesit etj. në kurikulat e tij. Ai është gjithashtu lehtësisht i qasshëm si nga ana gjeografike, po ashtu edhe ekonomike (duke menduar këtu ndryshimet në koston e jetesës mes qytetit të Shkodrës dhe kryeqytetit). Mësimdhënia e një cilësie të lartë, kërkimi shkencor dhe bashkëpunimet e ndryshme po paraqiten si elemente shumë të rëndësishme që sigurojnë ndikim në komunitetin përreth. Megjithatë, nevojitet një fleksibilitet më i gjerë për një përshtatje më të shpejtë ndaj kërkesave të kohës për ndërhyrje të menjëhershme për sa i takon zhvillimit të qëndrueshëm. Integrimi i qëndrueshmërisë në të gjitha disiplinat, krijimi i programeve të fokusuar në zhvillim të qëndrueshëm, angazhimi i studentëve në kërkime mbi qëndrueshmërinë, dhe bashkëpunimi me komunitetin lokal (OSHC, biznese, etj.) për të dhënë kontribut në gjetjen e zgjidhjeve për zhvillim të qëndrueshëm janë disa nga fushat ku mund të punohet më tepër në këtë institucion të arsimit të lartë.

### 3. GRUPET E PËRFSHIRA TË INTERESIT (STAKEHOLDERS)

Në këtë rajon nga skema e granteve të Iniciativës dhe Partneritetit janë shpallur fituese 4 organizata lokale:

- ✓ **3 Grante Initiative:** Shoqata Blini, OMP Liqeni i Shkodrës dhe Well-Point (1 Malësi e Madhe, 2 Shkodër);
- ✓ **1 Grant Partneriteti:** Forumi Shqiptar Liqeni i Shkodrës (Shkodër dhe Lezhë).

Temat e trajtuara kanë qenë ato të mbrojtjes së burimeve natyrore, ruajtjes së biodiversitetit, menaxhimit të mbetjeve dhe promovimit të eko-turizmit përmes rritjes së vetëdijes dhe angazhimit qytetar. Duke u fokusuar në praktikën e qëndrueshme, promovimin e trashëgimisë kulturore, dhe krijimin e mundësive ekonomike, të gjitha këto nëpërmjet ndërgjegjësimit dhe fuqizimit të komuniteteve lokale, projekti kërkon të japë kontribut për një të ardhme të qëndrueshme në rajon. Zona është e pasur me male, parqe e bukuri natyrore. Zhvillimi i praktikave që respektojnë këtë mjedis është një nevojë e menjëhershme për sigurimin e qëndrueshmërisë në rajon.

Gjatë zbatimit të projekteve, të katër shoqatat kanë përfshirë grupe të ndryshme interesi që veprojnë në territor, si më poshtë:

- Institucione: Bashkia Shkodër, Këshilli Bashkiak Shkodër, Bashkia Malësi e Madhe, Njësia Administrative Kastrat, Bashkia Lezhë, AdZM Shkodër, Sektori i Inspektimit dhe Kontrollit të Peshkimit, DAR, ZVA Shkodër.
- Shkolla të mesme:
  - Shkodër: Shkolla Profesionale "Hamdi Bushati", shkollat e mesme: "Jordan Misja", "28 Nëntori", "Oso Kuka";
  - Lezhë: Shkolla e Mesme "Hydajet Lezha";
  - Malësi e Madhe: Shkolla e Mesme "Dodë Kaçaj".
- Shkolla 9-vjeçare:
  - Shkodër: "Dëshmorët e Rrencit" (Gur i Zi), "Ernest Koliqi" (Shirokë)
  - Malësi e Madhe: "Prekë Gjoni" (Bajzë), "Fran Murrizi" (Pjetroschan).
- Komuniteti i peshkatarëve të liqenit të Shkodrës.
- Grupimi i të rinjve "Natyralistët", OSHC, komunitet, ekspertë, akademja, qendra sociale komunitare.

Tabela 1. Grupet e interesit të përfshirë në projektet zbatuese

GRUPET E INTERESIT TË PËRFSHIRË NË TOTAL	
Grupet e interesit të përfshirë	Numër
Institucione kombëtare e lokale	10
Universitete	2
Shkolla të mesme	6
Shkolla 9-vjeçare	4
OSHC	18
Ekspertë	11
Tregtarë fruta-perime	20+
Komunitet peshkatarësh	50
Komunitet (individë)	1029 +

#### Burimi: përmbledhje nga projektet

Përfshirja e grupeve të interesit në nivele të ndryshme ishte një nga objektivat që shoqëroi secilin nga projektet. Kështu, u përfshinë institucionet publike lokale si një hallkë shumë e rëndësishme në politikë-bërje që mund të kontribuojë në zhvillim të qëndrueshëm nëpërmjet miratimit të politikave e praktikave të qëndrueshme, angazhimit të komunitetit, mbështetjes së bizneseve lokale, mbrojtjes së burimeve natyrore apo nxitjes së transportit të qëndrueshëm.

U krijua një bashkëpunim i frytshëm me sistemin e edukimit në të tre nivelet (shkollë 9-vjeçare, e mesme, universitet) si pika shumë e rëndësishme kontakti me komunitetet lokale. Këto institucione, me integrimin e zhvillimit të qëndrueshëm në kurikulat e tyre dhe zhvillimin e projekteve që kanë këtë fokus, mund të ndikojnë në edukimin,

ndërgjegjësimin e fuqizimin e komuniteteve lokale, por edhe në gjenerimin e zgjidhjeve specifike për problematikat mjedisore në nivel lokal.

Bashkëpunimi e krijimi i lidhjeve me OSHC-të lokale u konsiderua si një element i rëndësishëm për sigurimin e qëndrueshmërisë së rezultateve të secilit prej projekteve. Këto organizata janë në kontakt të ngushtë me komunitetet dhe mund të ndikojnë në mënyrë të konsiderueshme në krijimin e lidhjeve mes aktorëve për të nxitur ndërgjegjësimin, krijimin e kapaciteteve, edukimin dhe promovimin e çështjeve mjedisore e sociale.

Angazhimi i ekspertëve ishte i domosdoshëm për të siguruar ekspertizë teknike, mbështetje në ndërtimin e kapaciteteve, edukimin, sigurimin e mbështetjes për gjetjen e zbatimit e zgjidhjeve për zhvillim të qëndrueshëm.


Përfshirja e tregtarëve të fruta-perimeve ishte shumë e vlefshme për të ndërgjegjësuar komunitetin që zgjidhjet ekzistojnë dhe që këto zgjidhje mund t'i gjejnë mes tyre. Të mësuarit nëpërmjet zbatimit në praktikë është një mënyrë shumë e mirë për angazhim, zhvillimin e të menduarit kritik e gjetje zgjidhjeje problematikash, si edhe bashkëpunim e komunikim. Ky projekt mund të shërbejë mjaft mirë si një ide për modele të qëndrueshme biznesi.

Komuniteti lokal ishte fokusi kryesor i zbatimit të projektit nëpërmjet angazhimit të drejtpërdrejtë në aktivitetet e projekteve nëpërmjet edukimit e trajnimit, dhënies së mendimeve, zbatimit të praktikave të qëndrueshme. Angazhimi i të rinjve në të tre nivelet e sistemit të edukimit siguron një ndikim jo të drejtpërdrejtë të familjeve e rretheve të tyre shoqërore. Promovimi i projekteve nëpërmjet materialeve të vizibilitetit e në rrjetet sociale, rrit ndikimin e projekteve dhe siguron qëndrueshmërinë e rezultateve të tyre. Numri i individëve të përfshirë në mënyrë të drejtpërdrejtë ose jo nga projektet vlerësohet të jetë më tepër se 8,000.


Aktivitetet e zhvilluara nga katër shoqatat lokale janë nga më të ndryshmet, që nga takimet informuese lidhur me prezantimet e projekteve përkatëse, përfshirjen e komuniteteve lokale në aktivitete, informimi dhe angazhimi qytetar, diskutimi e trajnimi, rrjetëzimi e fuqizimi i komunitetit.

Disa nga grupet e përfshira paraqiten në formë grafike si më poshtë vijon:

Grafiku 1. Gjinia e përfituesve të drejtpërdrejtë në rajon




Grafiku 2. Grupet e interesit (stakeholders) të përfshirë në projektet zbatuese



Për një zbatim sa më të suksesshëm të projekteve, ishin të domosdoshme takimet e realizuara më institucionet publike dhe komunitetin lokal (grafiku nr. 2). Takimet kishin qëllime të ndryshme, që nga komunikimi, ndërgjegjësimi, trajnimi e deri te ndërtimi i lidhjeve mes aktorëve (*networking*).

Grafiku 3. Takimet e realizuara në zbatim të projekteve



Në kuadër të projekteve të zbatuara janë nënshkruar 5 marrëveshje bashkëpunimi mes OSHC-ve dhe institucioneve lokale (bashkia Shkodër, Këshilli Bashkiak Shkodër, ZVA Shkodër, bashkia Malësi e Madhe, Shkolla e Mesme Profesionale "Hamdi Bushati" Shkodër).

Realizimi i 22 trajnimeve nga OSHC-të lokale kishte qëllim informimin, edukimin dhe ndërgjegjësimin e të rinjve dhe komunitetit për rëndësinë që ka mbrojtja e mjedisit për jetën socio-ekonomike dhe përdorimi në mënyrë të qëndrueshme i resurseve të vendit për zhvillim të qëndrueshëm lokal.

Për rritjen e ndikimit në komunitet janë realizuar:

- 6 kronika televizive (një nga OMP Liqeni i Shkodrës, 1 nga Well-Point dhe 4 nga FSLs) në TV-të lokale (TV1 Channel, Star Plus, TV Rozafa);
- 5,000 fletëpalosje;
- 82 postime në rrjete sociale;
- 2 postera;

Gjithashtu, prezantimi dhe zbatimi i praktikave të mira kishte për qëllim identifikimin dhe promovimin e metodave efektive dhe efikase për arritjen e rezultateve të dëshiruara. Mbjellja e 1,000 fidanëve nga FSLs në malin e Taraboshit dhe vendosja e 18 koshave të plehrave (12 kosha 80L dhe 6 kosha 240L nga Blini) janë praktika që mjaft mirë mund të aplikohen edhe në vende të tjera dhe të sigurojnë rezultate të qëndrueshme në një zonë relativisht më të madhe.

Vlen të përmenden gjithashtu edhe aktivitete të tjera (përtej atyre që lidhen direkt me projektet) ku me praninë e nën-granteve të financuara në kuadër të Green-AL është arritur një publik më i gjerë.

**3 aktivitete të hapura** për publikun e gjerë u organizuan në Shkodër: një në kuadër të "Javës së Europës" (03.05.2022), një në kuadër të "Javës së Kulturës Suedeze"

(13.09.2022), ku u prezantuan për publikun e gjerë programi Green-AL dhe projektet e zbatuara nga shoqatat (në nivel lokal, rajonal e kombëtar) si dhe çështjet mjedisore të trajtuara përmes zbatimit të projekteve të tyre.

Një ditë e hapur (28.02.2023) u organizua falë bashkëpunimit mes Universitetit Polis, FSLs dhe shkollave të përfshira në Panairin e Ideve–Qyteti im Ekologjik, që u vizitua edhe nga kryetari i bashkisë Shkodër dhe qytetarë të Shkodrës.

Një moment i rëndësishëm ishte edhe "**Forumi Kombëtar Mjedisor**" (05.05.2023), i zhvilluar në Tiranë, ku morën pjesë mbi 50 përfaqësues nga organizatat mjedisore në Shqipëri. Gjatë këtij aktiviteti u ngritën dhe u diskutuan shqetësime lidhur me problematikat mjedisore, ndryshimet klimatike, energjinë, ndotjen e mbrojtjen e habitateve natyrore. Theksi u vendos në nevojën për të trajtuar këto çështje nëpërmjet politikave dhe veprimeve konkrete, duke përfshirë të gjitha palët e interesit. Moment me rëndësi i punimeve të këtij Forumi ishte edhe firmosja e deklaratës së përbashkët të OSHC-ve, nëpërmjet së cilës u kërkuar që mjedisi të jetë një nga pesë prioritetet e axhendës së politikës kombëtare.

### 3.1 GRUPET E PËRFSHIRA TË INTERESIT (STAKEHOLDERS) SIPAS PROJEKTEVE SPECIFIKE

Kështu, shoqata Blini ka bërë prezantimin e projektit në dhjetor 2021 në praninë e përfaqësuesve të bashkisë Malësi e Madhe, njësisë administrative Kastrat (ku është zhvilluar projekti), AdZM Shkodër e OSHC-ve lokale. Në vazhdim, shoqata organizoi aktivitete rrjetëzimi me 2 shoqata të tjera lokale dhe 2 shkolla, njëra shkollë 9-vjeçare dhe tjetra e mesme. Qëllimi ishte informimi dhe ndërgjegjësimi i komunitetit për rëndësinë që ka mjedisi për jetën socio-ekonomike dhe përdorimi në mënyrë të qëndrueshme i resurseve të vendit për zhvillim lokal. Vendosija e koshave me ngjyra për ndarjen e mbetjeve në shkollën e mesme Bajzë (Malësi e Madhe) ishte një mënyrë për të gjetur një zgjidhje afatgjatë e për të paraqitur një praktikë të qëndrueshme e krejtësisht praktike për menaxhimin e mbetjeve. Në mënyrë të drejtpërdrejtë, shoqata, me aktivitetet e saj, ka përfshirë rreth 100 individë, por duke pasur parasysh ndërtimin e lidhjeve (*networking*), fuqizimin, promovimin e praktikave më të mira, shpërndarjen e 400 fletëpalosjeve të projektit etj., ndikimi është shumë më tepër se kaq. 5 ditët ekologjike të organizuara në bashkëpunim me grupet e interesit, ishin një mënyrë shumë e vlefshme, jo vetëm për pastrimin e territorit në 5 zona të ndryshme (ndër to dhe monumentet natyrore të "Hordhanat e Virit" dhe "Syri i Sheganit"), por edhe për ndërgjegjësimin e komunitetit të zonave për rëndësinë e mbrojtjes së mjedisit dhe mundësitë e zonës në ruajtjen e biodiversitetit dhe nxitjen e zhvillimit të eko-turizmit.



Tabela 2. Përmbledhje e projektit "Blini"

SHOQATA	BLINI
Emërtimi i projektit	Përmirësimi i imazhit të vendit përmes aktiviteteve mjedisore në Bajzë—Hani i Hotit (Malësi e Madhe)
Aktorët e përfshirë	Bashkia Kopluk, njësia administrative Kastrat, AdZM Shkodër, 2 OSHC lokale, 2 shkolla
Përfitues të drejtpërdrejtë	142 individë (68% djem/burra dhe 32% vajza/gra)

Organizata e Menaxhimit të Peshkimit (OMP) Liqeni i Shkodrës, informoi grupet e interesit lidhur me këtë projekt, ku të pranishëm ishin peshkatarë të zonës dhe përfaqësues nga AdZM, Sektori i Inspektimit dhe Kontrollit të Peshkimit dhe shoqata lokale. Aktivitetet e trajnimit përfshinë mbi 50 individë ku morën pjesë peshkatarë, inspektorati i peshkimit, përfaqësues nga academia. Përdorimi i metodës për përfshirjen e drejtpërdrejtë të peshkatarëve, rezultoi e vlefshme, jo vetëm në qëllimin primar të trajnimit (diskutimi i problematikave që sjellin rrjetat e mbetura në liqen dhe gjetja e zbatimi i zgjidhjeve për heqjen e tyre), por edhe për të rritur bashkëpunimin me peshkatarët e liqenit të Shkodrës. Këta të fundit diskutuan problematikën e tyre dhe u njohën me mundësinë për bashkëpunime për gjetje e zbatim zgjidhjesh. U realizuar trajnimet me dy shkolla 9-vjeçare për të treguar rëndësinë që ka ndërgjegjësimi për mbrojtjen e mjedisit dhe biodiversitetit. Në fakt, aktivitetet e trajnimit nuk ishin të përfshira në projekt-propozim, por gjatë zbatimit të projektit u konsiderua i rëndësishëm bashkëpunimi me shoqatën Blini, e cila punonte njëkohësisht në mbrojtjen, respektimin dhe vlerësimin e mjedisit, me fokus në liqenin e Shkodrës dhe zonat e mbrojtura natyrore në zonën e Kastratit. Diskutimet e nxënësve u fokusuan kryesisht në zonat e mbrojtura natyrore "Syri i Sheganit" dhe "Hordhanat e Virit". Bashkëpunimi me shkollat për trajnimin ishte i vlefshëm jo vetëm për ndërgjegjësimin e nxënësve për mbrojtjen e mjedisit dhe promovimit të monumenteve natyrore, por edhe për krijimin e urave të bashkëpunimit. Në të ardhmen, kjo do të ndikojë në qëndrueshmërinë e rezultateve të projektit. Gjithashtu, aktiviteti i pastrimit të liqenit nga rrjetat e braktisura shërbeu si një praktikë e mirë, për të cilën u theksua që duhet të kryhet në mënyrë periodike.

Tabela 3. Përmbledhës projekti "OMP"

SHOQATA	ORGANIZATA E MENAXHIMIT TË PESHKIMIT (OMP) LIQENI I SHKODRËS
Emërtimi i projektit	Pastrimi i mjedisit të Liqenit të Shkodrës nga rrjetat e braktisura
Aktorët e përfshirë	Peshkatarë, Inspektorati i Peshkimit, academia, studentë, OSHC, nxënës shkolle
Përfitues direkt	230 individë (73% djem/burra, 27% vajza/gra)

Shoqata *Well-Point* është fokusuar në një problematikë shumë të ndjeshme që ka të bëjë me humbjet dhe mbetjet ushqimore. Sipas (EEA, 2021) çdo familje shqiptare humbet 7-13 kg ushqim në vit, shifër që në nivel kombëtar shkon në 18,000 – 37,000 ton në vit, shifër

kjo e konsiderueshme, e cila me disa praktika të mira mund të ulet ose zhduket. Shoqata *Well-Point* bëri prezantimin e takimit mes të rinjve, përfaqësues nga shoqata e akademia. Identifikimi i shkollës së mesme profesionale "Hamdi Bushati" për të vazhduar me aktivitetet e projektit nuk ishte i rastësishëm. Kjo është një shkollë profesionale në qytetin e Shkodrës ku formohen individë që më pas punësohen në strukturat akomoduese (menaxherë, kamerierë, kuzhinierë, etj.).

Takimi në landfillin e Bushatit u krye me qëllimin e ndërgjegjësimit të nxënësve për ndikimin që kanë veprimet tona në mjedis. Për më tepër, në biznese ky ndikim do jetë edhe më i madh. Takimi i realizuar me personin përgjegjës për menaxhimin e mbetjeve urbane dhe ushqimore në të gjithë zonën shërbeu që nxënësit të kuptojnë se si funksionon i gjithë procesi i humbjeve ushqimore deri në landfill, i rëndësishëm ky për të kuptuar efektin pozitiv që ka ruajtja dhe menaxhimi i ushqimit.

Me nxënës, studentë, mësues dhe përfaqësues nga akademia u diskutuan mënyrat se si Shkodra mund të jetë një qytet më i mirë e më i pastër duke aplikuar praktikat më të mira. Me "Naturalistët" e rinj dhe dy shkollat e përfshira u organizuan trajnime për të siguruar informacion dhe rritur ndërgjegjësimin se si humbjet ushqimore ndikojnë në mjedis dhe roli që ka secili prej tyre në këtë çështje. Trajnimet u pasuan nga vizita në tregun e fruta-perimeve në Shkodër ku u vlerësuan në praktikë mundësitë e uljes së humbjeve nëpërmjet dhurimit të ushqimeve të mbetura, duke ia dhuruar qendrave sociale apo personave në nevojë. Prezantimi i "Vozës Rrotulluese" si një mënyrë për të kthyer mbetjet organike në pleh për tokën ishte një ide që përfshiu rreth 58 individë. Në fund të projektit, voza iu dhurua shkollës së mesme profesionale "Hamdi Bushati" për ta përdorur në mënyrë që ata të ulin humbjet e tyre nga ushqimet.

Tabela 4. Përmbledhje e projektit të "Well-Point"

SHOQATA	WELL-POINT-KUJDES PËR TË GJITHË
Emërtimi i projektit	Të rinjtë shkodranë kundër humbjeve ushqimore
Aktorët e përfshirë	Studentë, të rinj, akademia, OSHC, Njësia e Monitorimit të Shërbimeve Publike-Bashkia Shkodër, aktivistë, përfaqësues të landfillit të Bushatit, tregtarë fruta-perimesh, 2 qendra sociale
Përfitues të drejtpërdrejtë	297 individë (57% djem/burra, 43% vajza/gra)

Projekti i realizuar nga Forumi Shqiptar Liqeni i Shkodrës, u prezantua në praninë e përfaqësuesve të bashkisë Shkodër, Këshillit Bashkiak Shkodër, Drejtorisë Rajonale Arsimore, shoqërisë civile, studentë e përfaqësues nga akademia. U krye "Vlerësimi i nevojave dhe standardeve mjedisore për një Qytet Ekologjik-Bashkia Shkodër", për rezultatet e të cilit u zhvilluan takime me anëtarë të Këshillit Bashkiak Shkodër. Sugjerimet e qytetarëve u diskutuan mes këshilltarëve dhe gjithashtu u plotësuan nga mendimet e vlerësimet e tyre. Në shtator 2022 u prezantuan gjetjet dhe arritjet përfundimtare të analizës studimore "Potencialet dhe standardet e një Qyteti Ekologjik-Bashkia Shkodër" me qëllim që ky studim t'i shërbejë kësaj bashkie, këshillit bashkiak dhe të gjithë

institucioneve që kanë në fokus mjedisin në mënyrë që të kenë një vendimmarrje me fokus nevojat dhe kërkesat e vetë qytetarëve. Gjithashtu, takimi i kryetarit të bashkisë Shkodër me studentë të shkollës së mesme “Jordan Misja”, fitues të “Panairit të Ideve-Qyteti im Ekologjik” i dha mundësi nxënësve të vlerësoheshin për idenë e tyre, por dhe kryetarit të bashkisë të prezantojë projektet e bashkisë që ishin në të njëjtën linjë me koncept-idetë e nxënësve për një Shkodër të së ardhmes si qytet ekologjik.

Tabela 5. Përmbledhës projekti "FSLs"

SHOQATA	FORUMI SHQIPTAR LIQENI I SHKODRËS
Emërtimi i projektit	Lëvizja Rinore-Qyteti im Ekologjik
Aktorët e përfshirë	Bashkia Shkodër, Këshilli Bashkiak Shkodër, akademikë, aktivistë, ekspertë mjedisorë, AdZM Shkodër, 3 shkolla të mesme të përgjithshme Shkodër, 1 shkollë e mesme e përgjithshme Lezhë, Shkolla Pyjore (profesionale), OSHC, autoritete lokale e rajonale, Universiteti Polis, media.
Përfitues direkt	437 individë (34% djem/burra, 66% vajza/gra)

Nxënësit e përfshirë në konceptimin e ideve të gjelbra u pritën nga kryetari i bashkisë Shkodër dhe u nxitën që të vazhdojnë të japin kontribut me idetë dhe energjinë e tyre pozitive në zhvillimin e qytetit. Ideja fituese e panairit u prezantua edhe në Këshillin Bashkiak Shkodër dhe do të marrë jetë në programet e bashkisë për arritjen e OZhQ30. Për aktivitetin e mbjelljes së pemëve në malin e Taraboshit, organizata bashkëpunoi me AdZM Shkodër dhe, në bashkëpunim me Universitetin Polis, u zhvillua një punëtori me të rinjtë e përfshirë në panairin e ideve i cili pati në fokus diskutime mbi çështje të mjedisit në tërësi, për temat e planifikimit të qëndrueshëm, qyteteve ekologjike, si dhe për tendencat e zhvillimeve territoriale dhe mjedisore në bashkinë Shkodër. Universiteti Polis dhe Fabrika e Inovacionit mirëpriti, orientoi dhe aftësoi studentët në konsolidimin e koncepteve dhe propozimeve të tyre me përvojën më të mirë të pedagogëve dhe studiuesve shkencorë në fushën e mjedisit dhe urbanistikës.

Ky aktivitet synonte të nxiste dhe mbështeste nismat e bashkëpunimit midis të rinjve, komunitetit, institucioneve akademike/shkencore, organizatave të shoqërisë civile dhe organeve të pushtetit vendor për të faktorizuar gjithnjë e më shumë çështjet mjedisore në Shqipëri.

Vlerë të veçantë mori bashkëpunimi me akademinë, për nxitjen e praktikave të zhvillimit të qëndrueshëm, si dhe për rjetëzimin e aktorëve të përfshirë (sigurimin e qëndrueshmërisë së objektivave të projektit).

## 4. PROJEKTE TË ZBATUARA

### 4.1 PROJEKTI: PËRMIRËSIMI I IMAZHIT TË VENDIT PËRMES AKTIVITETEVE MJEDISORE NË BAJZË - HANI I HOTIT (MALËSI E MADHE)

**Organizata zbatuese:** Blini

**Bashkia/NjA/Zona e zbatimit:** Malësi e Madhe

Figura 7. Bashkia Malësi e Madhe



#### 4.1.1 SFONDI I ÇËSHTJES

Bashkia Malësi e Madhe ndodhet në veri të Shqipërisë dhe bën pjesë në qarkun Shkodër. Ajo ndahet në 6 njësi administrative: Koplik, Kastrat, Kelmend, Shkrel, Gruemirë dhe Qendër, me sipërfaqe 951.01 km<sup>2</sup> dhe popullsi të regjistruar 53,918 banorë (sipas Censurit 2011 është 30,823 banorë ("Njësitë Administrative," n.d.), me 3,140 ndërmarrje aktive ose rreth 27% të numrit të ndërmarrjeve në qarkun Shkodër (INSTAT, 2022). Zona është e njohur për turizmin dhe përpunimin e bimëve mjekësore e aromatike.

Fshati Bajzë dhe Hani i Hotit janë pjesë e njësisë administrative Kastrat dhe dy nga qendrat më të njohura të Malësisë së Madhe. Kjo njësi administrative zë një hapësirë prej 128.7km<sup>2</sup> ku banojnë rreth 12,184 banorë dhe ku ndodhen katër shkolla 9-vjeçare dhe dy shkolla të mesme, me rreth 665 nxënës, një numër relativisht i madh në bashkinë Malësi e Madhe.

Njësia administrative Kastrat ka një sipërfaqe të ndarë në 70% malore dhe 30% liqenore (liqeni i Shkodrës). Kjo njësi kufizohet me Malin e Zi dhe karakterizohet nga kultivimi i lartë i bimëve mjekësore, si: sherbelë, livandë, makth (*helichrysum italicum*) dhe duhan.

Në vitet e fundit, kjo njësi po bëhet e njohur edhe për aktivitetin turistik, kryesisht i përfaqësuar nga restorantet që shërbejnë produkte lokale, si mishi dhe peshku, por edhe për prodhuesit e vegjël të mjaltit, baxhot, etj. Për sa i përket pjesës liqenore, ajo dallohet për aktivitetin në nivel familjar të peshkimit, i cili është baza ekonomike për një pjesë të konsiderueshme të familjeve në këtë territor.

Njësia administrative Kastrat, sikurse i gjithë territori i Malësisë së Madhe, po përballlet me probleme që kanë ndikim të madh tek zhvillimi i qëndrueshëm i tij. Ka zona ku infrastrukturë dhe shërbimet janë jo të përshtatshme, ndërsa aktivitetet rurale të pranishme janë të zhvilluara në atë nivel që shërben vetëm për mbijetesë. Kapaciteti financiar e teknik por edhe vetëdija qytetare janë të pakta, si edhe ka potenciale liqenore të pashfrytëzuara e degradim të mjedisit. Rritja e numrit të turistëve që vizitojnë burimet natyrore të zonës ka vënë në pah mungesën e informacionit lidhur me pikat natyrore të interesit apo edhe qasjes ndaj tyre. Dëshira e banorëve për të shfrytëzuar mundësitë për përfitim nga rritja e turizmit, e shoqëruar kjo me njohuritë e munguara për mjedisin, mund të çojë në humbje të biodiversitetit, shkatërrim mjedisor, rritje të ndotjes e dëmtim të burimeve natyrore.

Duke qenë se pjesa fundore e "Përroit të Thatë" në njësinë administrative Kastrat, e shtrirë në të gjithë luginën Shkrel, mbledh një sasi të lartë mbetjesh që në kohë shirash të shumtë i sjell dhe i derdh në liqenin e Shkodrës dhe zonën Pjetroshan (njësia administrative Kastrat), si dhe Kamicë (njësia administrative Qendër), ky përbën një problem ky mjaft shqetësues për këtë territor. Duhet shtuar edhe se, për vite me radhë, fshati Pjetroshan ka shërbyer si pikë grumbullimi (hedhjeve) të të gjitha mbeturinave të bashkisë Malësi e Madhe, nga pamundësia për t'i dërguar në landfillin e Bushatit. Fatmirësisht, në dy vitet e fundit kjo situatë ka ndryshuar pasi është realizuar nënshkrimi i një kontrate me landfillin e Bushatit dhe mbetjet po dërgohen atje. Nga ana tjetër, pika e grumbullimit në Pjetroshan nuk është rehabilituar dhe vazhdon të shkaktojë dëme të mëdha për këtë fshat, por edhe për liqenin e Shkodrës, pasi pika ndodhet shumë afër tij. Sidomos gjatë dimrit, nga shirat dhe reshjet, një sasi e konsiderueshme mbetjesh shpërndahet dhe transferohet në ujërat e liqenit.

Njësia administrative Kastrat është një zonë që deri tani nuk ka qenë në fokusin e projekteve apo donatorëve të mëdhenj, përveç projekteve dhe nismave të vogla ose kontributit nga diaspora, ku lidhur me mbrojtjen e mjedisit mund të përmendim mbjellje pemësh, pastrime pyjesh, etj. Në vitin 2019, në fshatin e Bajzës janë ndërtuar dy ishuj ekologjikë (nga 8 të ngritur gjithsej në bashkinë Malësi e Madhe) të pajisur me 4 kosha për grumbullimin e ndarë të mbetjeve në katër rryma dhe janë zhvilluar me nxënësit e shkollave disa trajnime informuese mbi mirëmenaxhimin e mbetjeve në kuadër të projektit "Green Lands-Ishujt e Gjelbër" (CFCU/MNE/049), i financuar nga Programi i Bashkëpunimit Ndërkufitar Mali i Zi—Shqipëri 2014 – 2020 në kuadër të Instrumentit për

Figura 8. Bashkia Malësi e Madhe sipas njësive administrative



Asistencën e Para-anëtarësimit 2014 – 2020 (IPA II) dhe i zbatuar në Malësi të Madhe nga organizata VIS Albania dhe Bashkia Malësi e Madhe në partneritet me bashkinë Berane dhe Caritas në Mal të Zi. Kjo nismë ka ndikim në ndërgjegjësimin e banorëve për ndarjen dhe seleksionimin e mbetjeve, por e pamjaftueshme për zgjidhjen e çështjeve mjedisore në këtë territor dhe në liqenin e Shkodrës.

Liqeni i Shkodrës është më i madhi në Gadishullin Ballkanik, me një sipërfaqe prej 370 km<sup>2</sup> (2/3 pjesë e Malit të Zi dhe 1/3 pjesë e Shqipërisë). Në Shqipëri ka rreth 170,000 banorë në zonën e liqenit, e cila u bë zyrtarisht Rezervat Natyror me Dekretin 684 të vitit 2005 (26,535 ha). Llojet endemike në këtë liqen janë: Mikroalga 2 (*Cyclotella scadariensis*, *Cymbella scutariana*), Oligochetes 1 (*Peloscocles scodranensis*), Moluskë 9 (2 në liqen), Bimët ujore 1 (*Trapa longicarpa subsp.*

*Scutariensis*), Peshku 2 (*Pachychilon pictum*, *Salmothymus obtusirostris zetensis*), Amfibët 1 (*Rana shqiperica*), bimët tipike endemike tokësore për Ballkanin. Ndërsa kërcënimet kryesore për trashëgiminë natyrore (Dhora et al., 2016) në Liqenin e Shkodrës janë:

- ✓ **prishja e regjimit ujq** si rezultat i pranisë së hidrocentraleve përgjatë lumit Drin gjë që sjell lëkundje të mëdha e të shpeshta, duke ndikuar kështu në ekosistemin e liqenit;
- ✓ **peshkimi i paligjshëm dhe i pakontrolluar**, gjë që ka çrregulluar transferimet e energjisë, strukturat e zinxhirëve ushqimorë dhe popullatat e peshqve, si dhe ka çuar në prishjen e strukturës llojore të resurseve të peshqve, në favor të peshqve jocalësorë e rënie të prodhimit në përgjithësi;
- ✓ **mungesa e monitorimit të vazhdueshëm dhe të përshtatshëm të biodiversitetit** nga ana e strukturave shtetërore të biodiversitetit, si dhe

- ✓ **ndotja nga ujërat e zeza dhe hedhja e mbetjeve**, të cilat së bashku sjellin shkatërrime të skemës ekologjike që mban gjallë liqenin;

Për këto arsye, është e rëndësishme që të përdoren skema të integruara që sigurojnë zhvillim të qëndrueshëm të liqenit dhe rajonit, që liqeni të kontribuojë në jetën e komunitetit lokal, por edhe njerëzit të kryejnë shërbime "shpërblyese" ndaj liqenit (Dhora et al., 2016).

Një pikë e veçantë dhe me rëndësi të lartë në liqenin e Shkodrës është "Syri i Sheganit" (Monumenti i Mbrojtur i Natyrës), i krijuar si rezultat i erozionit, ku dy burime që njihen si "Syri i Sheganit" dhe "Hordhanat e Virit" lidhen nën tokë me njëri-tjetrin në zgavrat e krijuara nga erozioni. Këto monumente janë vende tërheqëse, me bukuri të jashtëzakonshme, me ujën e kristaltë e të freskët që buron nga thellësia e tokës. Tani, këto dy monumente natyrore po bëhen mjaft të njohura dhe të vizituara duke zhvilluar një turizëm të ri për njësinë administrative Kastrat që është turizmi liqenor, i cili deri tani nuk ka ekzistuar këtui. Turizmi, nëse nuk menaxhohet siç duhet, sjell edhe dëme që vijnë nga shtimi i numrit të vizitorëve, grumbullimi i mbetjeve dhe zhvillimi i tepruar i burimeve turistike. Këto mund të sjellin ndotje të ujërave, tokës, ajrit dhe zhurmë. Prandaj dhe disa elemente siç janë p.sh. mbetjet dhe mbrojtja e burimeve natyrore duhen menaxhuar në mënyrën e duhur që nga fillimi.

Figura 9. Pamje nga "Syri i Sheganit", monument natyre



Një tjetër element i rëndësishëm për zhvillimin e turizmit në këtë vend është shënjimi i dy shtigjeve që të çojnë te këto dy burime, të cilat janë të përshtatshme për të gjitha moshat, për ecje malore (*hiking*) ose edhe për biçikletat, duke i bërë "Syrin e Sheganit" dhe "Hordhanat e Virit" më të qasshme për të gjithë.

Mbi këto objektiva mjedisore dhe të zhvillimit të turizmit në njësinë administrative Kastrat është zhvilluar edhe projekti i shoqatës Blini "Përmirësimi i imazhit të vendit përmes aktiviteteve mjedisore në Bajzë-Hot, Malësi e Madhe", duke e konsideruar të

rëndësishëm rritjen e vëmendjes së komunitetit lokal dhe strukturave vendimmarrëse ndaj këtyre problemeve dhe mbi të gjitha ndaj këtyre pasurive natyrore që ka ky territor që nga njëra anë mund të shërbejnë si një burim për zhvillimin ekonomik-social në zonë, por nga ana tjetër duhet të trajtohen që të mos ketë ndikim negativ mjedisor.

Shoqata Blini është krijuar në vitin 2006, kohë nga e cila ka kontribuar mjaft për zonën e Kastratit, me fokus mbrojtjen e pyjeve nëpërmjet aksioneve për pastrimin e tyre, ndërtimin e pritave për mbrojtjen nga erozioni, mbjelljen e pemëve, etj. Gjithashtu, kontributi i shoqatës Blini është i lartë për ndërtimin e lerave të ujit, të domosdoshme në zhvillimin e blegtorisë në këto zona malore dhe ku ky aktivitet ka rëndësi jetike. Në vitet e fundit aktiviteti i shoqatës është i përqendruar në mbrojtjen e mjedisit dhe zhvillimin e turizmit lokal.

#### 4.1.2 PËRSHKRIMI I ÇËSHTJES SË TRAJTUAR

Përgjatë periudhës nëntor 2022 – korrik 2022, shoqata Blini zbatoi projektin “Përmirësimi i imazhit të vendit përmes aktiviteteve mjedisore në Bajzë – Hot, Malësi e Madhe”, i cili kishte si objektiv të përgjithshëm përmirësimin e imazhit dhe bërjen e vendit më tërheqës nëpërmjet aktiviteteve mjedisore për të mundësuar krijimin e një mjedisi të pastër dhe të shëndetshëm për vizitorët dhe ekosistemet natyrore.

Gjatë periudhës së zbatimit të projektit, shoqata Blini ka realizuar aktivitete për promovimin e projektit, me pjesëmarrje të aktorëve të ndryshëm lokalë, të cilët shprehën

Figura 10. Takimi hapës i projektit





mbështetjen e tyre për arritjen e rezultateve të tij. Në fazën fillestare, vëmendjen kryesore e kishin informimi i aktorëve të interesit dhe i komunitetit të njësisë administrative Kastrot mbi zbatimin e këtij projekti dhe mënyrën e përfshirjes së tyre në projekt, me të cilët u kryen takime paraprake para fillimit të aktiviteteve, përmes pjesëmarrjes në aktivitetin hapës (*kick-off*) dhe në aktivitetet që u zhvilluan përgjatë zbatimit.

Aktivitetet konkrete në terren morën jetë me përfshirjen e nxënësve të shkollës 9-vjeçare "Prekë Gjoni" në Bajzë, përmes zhvillimit të një aksioni pastrimi 5-ditor në zonat e shënuara të projektit (pika kufitare; bregu i liqenit; aksi rrugor; monumentet e natyrës "Hordhanat e Virit" dhe "Syri i Sheganit"), të cilat përveç angazhimit për pastrimin nga mbetjet kishin edhe karakter informues dhe ndërgjegjësues mbi rëndësinë që ka mbrojtja e mjedisit dhe e pasurive të zonës. Rreth 46 nxënës në ditë morën pjesë në 5 ditët e aksionit për pastrimin e mbetjeve në zonat e synuara të projektit (mesatarisht 35% vajza/gra dhe 65% djem/burra). Angazhimi i nxënësve në këtë aktivitet praktik u konsiderua një vlerë e shtuar, pasi shërbeu si një model jo vetëm për gjithë nxënësit, por edhe për vetë komunitetin.

Me qëllim informimin dhe rritjen e vetëdijes për çështjet mjedisore, në Bajzë u zhvillua një trajnim me nxënësit e shkollës 9-vjeçare "Prekë Gjoni", gjatë të cilit u përfshin 32 të rinj (13 vajza/gra dhe 19 djem/burra). Përfshirja dhe angazhimi i të rinjve u gjykuan si të rëndësishme pasi kjo grup-moshë mund të sjellë ndryshim në përmirësimin e gjendjes së mjedisit dhe kontributit që mund të japë nëpërmjet shpërndarjes së njohurive e shkëmbimit të ideve në shkollë, familje dhe komunitet.

Figura 11. Trajnimi dhe pastrimi i mbetjeve në bashkëpunim me nxënësit e shkollës 9-vjeçare "Prekë Gjoni" në Bajzë





Trajnimi u fokusua në ndërgjegjësimin e të rinjve dhe komunitetit mbi rëndësinë që ka mbrojtja e natyrës dhe e mjedisit dhe promovimi i monumenteve të natyrës për zhvillimin e eko-turizmit në zonë. Me qëllim përmirësimin e ofertës turistike të zonës dhe nxjerrjes në pah të potencialeve të saj, u shënjuan 8.5 km shtigje nga rruga kryesore për tek monumentet e natyrës “Hordhanat e Virit” dhe “Syri i Sheganit”. Shënjimi i këtyre shtigjeve do të ndihmojë turistët dhe vizitorët e ndryshëm për orientimin dhe njohjen me peizazhin mbresëlënës që këto zona ofrojnë. Para procesit të shënjimit të shtigjeve, përmes aktiviteteve të projektit dhe përfshirjes së nxënësve të shkollave, u bë i mundur pastrimi i mbetjeve nga kjo zonë, me synim përmirësimin e peizazhit, dhënien e një modeli praktik dhe mbrojtjen e burimeve natyrore nga ndotja. U pastruan nga mbetjet pesë pika me rëndësi strategjike të kësaj zone, nga ku u hoqën 520 thasë me mbetje dhe me mbështetjen e autoriteteve lokale u transportuan në landfillin e Bushatit.

Figura 12. Foto nga shënjimi i shtegut në monumentet e natyrës “Hordhanat e Virit” dhe “Syri i Sheganit”



Përmes projektit, u bë e mundur vendosja e koshave për grumbullimin e ndarë të mbetjeve në shkollën “Dodë Kaçaj” në Bajzë, dhe tek kjo e fundit u kryen edhe disa punime për përmirësimin e mjedisit të jashtëm. U blenë gjithsej 18 kosha (12 kosha 80 litër dhe 6 kosha nga 240 litër).

Figura 13. Vendosja e koshave & përmirësimi i mjedisit të jashtëm pranë gjimnazit “Dodë Kaçaj” në Bajzë



Me qëllim krijimin e një aleance mjedisore lokale në mënyrë që në zonë të jenë të pranishëm jo vetëm ndërgjegjësimi, por edhe aksioni qytetar, u kryen tre takime me në fokus ndërtimin e lidhjeve lokale (*networking*) me nxënës, mësues dhe shoqata mjedisore, përkatësisht me shkollat në Pjetrosan dhe Bajzë dhe me dy shoqatat mjedisore “Bjeshka” dhe “Agro Reçi”. Në këto takime rrethëzimi u përfshinë gjithsej 63 individë (22 vajza/gra dhe 41 djem/burra). Në rastin konkret, ndërtimi i këtyre lidhjeve është një vlerë e shtuar, pasi bashkëpunimet mund të sigurojnë mundësi që nxënësit të mund të zbatojnë njohuritë dhe aftësitë e tyre në praktikë, me mbështetjen e ofruar nga njësia administrative Kastrat, drejtuesit e shkollave, organizatave mjedisore në zonë dhe komunitetit. Ky bashkëpunim mbetet i frytshëm pasi siguron qëndrueshmërinë e objektivave të projektit, duke e shtrirë ndikimin përtej periudhës së zbatimit të tij.

Më datë 5 maj 2022, Shoqata Blini mori pjesë në Forumin Kombëtar Mjedisor, të organizuar në kuadër të programit Green-AL, duke qenë pjesë e diskutimeve të tryezës mbi “Ndotjen e Mjediseve Urbane dhe Natyrore”.

Qëndrueshmëria e projektit mund të sigurohet përmes bashkëpunimit të mëtejshëm me institucionet publike, të rinjtë dhe komunitetin jo vetëm për të vijuar me ndërgjegjësimin mbi potencialet që zotëron territori në terma mjedisorë dhe të eko-turizmit, por edhe për të bërë të mundur që veprime të angazhimit qytetar të jenë të pranishme në zonë edhe pas përfundimit të projektit. Të gjitha ndërhyrjet për mbrojtjen e mjedisit vlerësohen shumë të rëndësishme duke konsideruar dëmin që njeriu i shkakton çdo ditë mjedisit me

keqmenaxhimin e mbetjeve dhe mosrespektimin e biodiversitetit, çka sjell jo vetëm ndikim mjedisor, por edhe ekonomik e social, për komunitetin e zonës, por dhe më gjerë.

#### 4.1.3 PËRFUNDIME

- Mbrojtja e mjedisit dhe mirëmenaxhimi i mbetjeve është një problematikë e gjerë në Njësinë Administrative Kastrat, por edhe në të gjithë territorin e Malësisë së Madhe, kështu që përveç ndërhyrjeve që ka realizuar projekti, ka edhe shumë vende të tjera që kërkojnë në mënyrë urgjente një vëmendje të shtuar nga të gjithë aktorët në komunitet. Më specifikisht, pika e grumbullimit të mbetjeve në fshatin Pjetroschan dhe derdhja në Përroin e Thatë janë dy problematika që kërkojnë urgjentisht vëmendje dhe investime jo të vogla për rehabilitimin e tyre. Gjithashtu, është e rëndësishme që monumentet e natyrës "Syri i Sheganit" dhe "Hordhanat e Virit" të jenë nën kujdes të vazhdueshëm si nga komuniteti, ashtu edhe nga institucionet lokale dhe Administrata Rajonale e Zonave të Mbrojtura sepse rritja e konsiderueshme e numrit të vizitorëve në këtë vend shton edhe rrezikun e keqmenaxhimit të mbetjeve dhe dëmtimit të natyrës së këtyre dy monumenteve natyrore. Vendosija e disa koshave të vegjël që janë më të qasshëm nga vizitorët, ndërtimi i një banje publike, përcaktimi i zonave që mund të përdoren për piknik ose për aktivitete sportive, vendosja e disa tabelave ndërgjegjësuese për mbrojtjen e mjedisit dhe biodiversitetit, etj., janë veprime ndihmëse për mbrojtjen e këtij mjedisi dhe vazhdimësinë e rezultateve të arritura nga projekti. Promovimi dhe përmirësimi i sektorit turistik në Njësinë Administrative Kastrat është një aspekt me tepër rëndësi për këtë territor, pasi do të ishte një mundësi për zhvillimin ekonomik dhe të qëndrueshëm të territorit, duke rritur punësimin, duke lehtësuar apo parandaluar emigracionin, duke rritur investimet, etj.
- Nxënësit që morën pjesë në aktivitetet e projektit janë mënyra më e shpejtë dhe e sigurt e shpërndarjes së duhur të informacionit tek komuniteti, pasi ata i përçojnë saktë njohuritë edhe në familje e shoqëri, duke nxitur menaxhimin më të mirë të mbetjeve në këtë territor.
- Bashkëpunimi me shkollat dhe stafet pedagogjike në këtë projekt dëshmoi se këto institucione janë të gatshme dhe, jo rrallë, japin kontribut në mbrojtjen e mjedisit.
- Ndërtimi i lidhjeve me shkollat dhe me organizatat mjedisore lokale të shoqërisë civile gjithashtu ndihmoi në shpërndarjen më të gjerë të informacionit dhe rritjen e ndërgjegjësimit në komunitetin e Malësisë së Madhe.

#### 4.1.4 SUGJERIME

1. Në bashkinë Malësi e Madhe paraqitet një gjendje mjedisore që duhet të përmirësohet për t'i shërbyer zhvillimit socio-ekonomik. Në mënyrë të veçantë, kujdes duhet t'i kushtohet zonës bregliqenore dhe territoreve malore që përbëjnë atraksionet kryesore turistike duke zhvilluar aksione të vazhdueshme pastrimi dhe informimi me komunitetin dhe turistët për të mirëmenaxhuar këto pasuri natyrore.
2. Zhvillimi i orëve mësimore për çështje që lidhen me ndarjen e mbetjeve në burim, duhet të kthehet në një praktikë të vazhdueshme në shkollat e kësaj bashkie.
3. Promovimi i praktikave për pakësimin e mbetjeve nëpërmjet kompostimit dhe riciklimit.
4. Rehabilitimi i vendgrumbullimit të mbetjeve në fshatin Pjetrosan, pastrim i tij dhe mbjellje pemësh.
5. Fushata e pastrimit të shtratit të Përroit të Thatë dhe ndërgjegjësimi i komunitetit që banon në të gjithë hapësirën e tij (lugina Shkrel, Koplík dhe Kastrat) për dëmin që shkaktojnë duke i hedhur mbetjet në këtë mënyrë (specifikojmë që Kanioni i Poicës, pjesë e Përroit të Thatë është edhe Monument i Mbrojtur i Natyrës).
6. Ndërgjegjësimi i banorëve që të hedhin mbetjet në PGM-të përkatëse, të ndajnë mbetjet inerte nga ato shtëpiake dhe të paguajnë tarifën e shërbimit.
7. Zëvendësimi i koshave të dëmtuar dhe plotësimi me kosha në masën e nevojshme.
8. Aplikimi i gjobave në rast të mosrespektimit të masave për mbrojtjen e mjedisit;
9. Trajnime e takime të vazhdueshme me komunitetin mbi vlerat e natyrës dhe përdorimi i tyre në mënyrë të qëndrueshme.
10. Zhvillimi i aktiviteteve ndërgjegjësuese duke angazhuar komunitetin në aksionet e pastrimit të territorit.
11. Ndërtimi i infrastrukturës në funksion të ruajtjes dhe promovimit të resurseve natyrore në mbështetje të shtimit të cilësisë dhe llojshmërisë së ofertës turistike për vizitorët në këtë territor, shënjimi me sinjalistikë, si edhe vendosja e tabelave informuese.
12. Trajnimi i banorëve të zonës si guida turistike për promovimin e monumenteve natyrore.

Në sezonin e verës duhet të vendosen burime njerëzore në gatishmëri nga bashkia për mirëmbajtjen e monumenteve të natyrës.

## 4.2 PROJEKTI: PASTRIMI I MJEDISIT TË LIQENIT TË SHKODRËS NGA RRJETAT E BRAKTISURA

**Organizata zbatuese:** Organizata e Menaxhimit të Peshkimit (OMP) Liqeni i Shkodrës

**Bashkia/NjA/Zona e zbatimit:** Shkodër, Malësi e Madhe, Liqeni i Shkodrës

### 4.2.1 SFONDI I ÇËSHTJES

Liqeni i Shkodrës është një nga liqenet me sipërfaqen ujore më të madhe në gadishullin e Ballkanit dhe me një shumëllojshmëri të specieve ujore, peshqve dhe shpendëve autoktonë dhe shtegtues, me vlerë ekonomike dhe jo-ekonomike.

Figura 14. Pamje nga Liqeni i Shkodrës



Pasqyra e tij ujore gjendet në një lartësi 6 metra mbi nivelin e detit dhe ka një sipërfaqe prej 368 km<sup>2</sup>, nga të cilat 149 km<sup>2</sup>, me një gjatësi brigjesh prej 57 km, i përkasin Republikës së Shqipërisë, ndërsa pjesa tjetër Malit të Zi. Sipërfaqja ujore në territorin malazez është shpallur Park Kombëtar që nga viti 1983 ndërsa sipërfaqja ujore në territorin shqiptar është një Rezervat Natyror i Menaxhuar<sup>2</sup>, duke e bërë në thelb të gjithë liqenin një zonë të mbrojtur. Liqeni i Shkodrës dhe zonat përreth janë shpallur Zonë e Mbrojtur me VKM nr. 684 datë 02.11.2005.


Rezervatet Natyrore të Menaxhuara ose Parqet Natyrore (kategoria IV) përfaqësojnë zona me ndërhyrje aktive të njeriut për qëllime menaxhimi të llojeve dhe habitateve, në mënyrë që të garantohet ruajtja e habitateve dhe të plotësohen kërkesat specifike të llojeve me rëndësi rajonale e vendore, si dhe zonat që përdoren për qëllime studimore, edukative dhe kulturore (AKZM, 2023b). Qëllimi kryesor i shpalljes së këtyre zonave është “dhënia e të drejtës për mbrojtje”. Kjo do të thotë që pasuritë e tyre të përdoren në

<sup>2</sup> <http://akzm.gov.al/zonat/620645afeb221f961af86a98>

mënyrë të kontrolluar, përmes parimit të shfrytëzimit të qëndrueshëm, pa shkaktuar dëmtimin e pasurive natyrore dhe biodiversitetit që ato mbartin.

Liçeni i Shkodrës është shpallur Zonë e Mbrojtur në të gjithë sipërfaqen e tij pasi është një vend kryesor pushimi për zogjtë shtegtues dhe është rezerva më e madhe e shpendëve në Europë. Liçeni i Shkodrës ka një sipërfaqe të madhe ligatinore, e cila ka rëndësi ndërkombëtare për ruajtjen e biodiversitetit e për këtë arsye Liçeni i Shkodrës është në listën e zonave Ramsar<sup>3</sup>. Në pjesën perëndimore, prej daljes së Bunës e deri në kepin e Radushës, bregu është shkëmbor, me shumë gjire, kepe dhe ishuj. Në liçen numërohen mbi 50 ishuj (Dhora et al., 2016) që kanë interes dhe rëndësi studimi nga pikëpamja gjeologjike, gjeografike dhe ekologjike pasi ato luajnë një rol shumë të rëndësishëm në biologjinë e liçenit. Duke qenë mjedisë relativisht të izoluar me bimësi interesante, ato shërbejnë si strehë dhe vende riprodhimi për shpendët dhe kafshët e tjera.

Figura 15. Rrjeti i Zonave të Mbrojtura dhe Parku Natyror “Liçeni i Shkodrës”



Burimi: <https://www.cepf.net/sites/default/files/shkodra-management-plan-albanian.pdf>

<sup>3</sup> <https://www.cbd.int/doc/lifeweb/albania/Network%20of%20Protected%20Areas%20in%20Albania.pdf>

Liqeni i Shkodrës ka një breg shumë të larmishëm të tipit të ulët të "marsheve" në veri dhe shkëmbor në jug. Në bregun jugor shquhen plazhet në rrugën nga Shkodra për në Shirokë e Zogaj, ku më i madhi është plazhi i Zallit të Bardhë.

Figura 16. Pozicionimi i Liqenit të Shkodrës në Rajon



Pika më e thellë e liqenit është rreth 45 metra. Në skajin juglindor shtrihet Shkodra, nga ku merr edhe emrin. Liqeni i Shkodrës dhe kryesisht zona e Shirokë–Zogaj, përbën një kompleks habitatesh të shumtë, të përshtatshëm për praninë e një larmie organizmash të gjallë. Kjo shumëllojshmërie lartë biologjik i dedikohet veprimit të faktorëve favorizues, kryesisht të karakterit ekologo-gjeografik.

Fauna e liqenit është e shumëllojshme dhe e pasur me 45 lloje peshqish e 270 lloje shpendësh. Këto shpendë përbëjnë 87% të gjithë ornitofaunës së Shqipërisë<sup>4</sup>. Një perlë e kësaj pasurie është padyshim pelikani, zogu më i madh në Europë. Liqeni i Shkodrës është i njohur për larminë e llojeve të peshqve objekt peshkimi. Sipas Dhora et al. (2016), lista e peshqve (*Actinopterygii*) të liqenit të Shkodrës dhe ujërave të pasura përmban 52 specie. Familja *Cyprinidae* ka 25 specie, ose 48% të totalit, çka konsiderohet përqindje e lartë dhe ky fakt e karakterizon liqenin dhe iktiofaunën e tij si ciprinidë. Ujërat përreth liqenit dhe iktiofauna e tyre janë salmonide. Në liqen janë gjetur 9 specie të familjes *Salmonidae* (17.3%). Speciet autoktone të liqenit të Shkodrës janë gjuca (*Alburnus scoranza*) dhe krapa (*Cyprinus carpio*) me vlerë të madhe për ekonominë lokale dhe më gjerë. Speciet migruese (përmes Lumit Buna në det) si kubla (*Alosa agone*), ngjala (*Anguilla anguilla*), qefulli i verës dhe qefulli i vjeshtës (*Mugil cephalus* dhe *Liza ramado*) janë resurse peshkore me rëndësi të veçantë. Krahas specieve rezidente dhe migratore në liqen janë prezantuar edhe specie të tjera si karasi (*Carassius gibelio*) dhe sharmaku (*Perca fluviatilis*).

<sup>4</sup> Qarku i Shkodrës - Wikipedia



Flora e fauna e Liqenit të Shkodrës karakterizohet nga një endemizëm i ulët. Endemike konsiderohet bima *Quercus robur scutariensis* dhe ndoshta *Trapa natans* (nënloji i Liqenit të Shkodrës). Nga kafshët endemike përmendim peshqit *Pachychilon pictum* dhe *Salmothymus obtusirostris zetensis*, bretkosën *Rana shqiperica*, oligoketin *Peloscoclex scodraensis*, si dhe disa gaforre amfipodë, kryesisht të gjinisë *Niphargus*. Numri i endemikëve shumëfishohet nëse shqyrtojmë krejt florën dhe faunën e pellgut të liqenit të Shkodrës. Në kategoritë e larta taksonomike dukuria e endemizimit mungon. Një interes të veçantë paraqesin reliktet e terciarit, që sot banojnë në Liqenin e Shkodrës. Si të filla përmendim bimën *Utricularia vulgaris* dhe ndër kafshët, disa specie amfipodësh të gjinisë *Typhlogammarus*. Fauna autoktone e peshqve karakterizohet gjithashtu si faunë e vjetër terciare. Afër 700 lloje bimësh dhe kafshësh mikroskopike gjenden sipër dhe midis makrofiteve të bregut. Ato luajnë një rol të rëndësishëm në rrjetin ushqimor të këtij ekosistemi. Në disa grupe gjallesash, sidomos *Amphipoda*, *Mollusca*, *Pisces*, *Amphibia*, *Reptilia*, etj., gjen aq nënloje, sa edhe lloje. Në shumë lloje vihen re shfaqjet e polimorfizmit të individëve në popullatë. Për disa lloje peshqish e amfibësh njihen format hibride.

Të gjithë këto shembuj të lartpërmendur shprehin shumëllojshmëri gjenetike, një zhvillim evolutiv nëpërmjet dukurisë së përzgjedhjes natyrore. Janë evidentuar 20 lloje bimore dhe 123 shtazore ujore të kërcënuara (gjë që tregon një nevojë të menjëhershme për ndërhyrje). Në këtë numër përfshihen llojet në zhdukje, të kërcënuara, të rralla, endemike, me vlera shkencore dhe ato me informacion jo të plotë për kategorizim.

Për Liqenin e Shkodrës njihen rreth 850 lloje bimore dhe 600 lloje shtazore. Në pellgun e liqenit të Shkodrës njihen rreth 1,900 lloje bimore dhe ndoshta 3,500 – 4,000 lloje shtazore<sup>5</sup>. Flora dhe fauna e liqenit ka elemente detare, ndonëse me popullaritet të vogël. Shkaku i kësaj dukurie duhet të lidhet ndoshta me hyrjen e tyre nëpërmjet Bunës. Si të fillë, përmendim bimën *Zostera marina*, gaforren *Echinogammarus veneris*, si dhe shumë lloje peshqish që shfaqin dukurinë e migrimit biologjik për në det.

Në këtë liqen zhvillojnë aktivitetin e tyre ekonomik peshkatarët e Organizatës së Menaxhimit të Peshkimit (OMP) Liqeni i Shkodrës. Përpara viteve '90 peshkimi ishte një ndërmarrje shtetërore, e cila zhvillonte aktivitetin në kuadër të ligjeve në fuqi. Pas viteve '90, me ndryshimin e sistemit politik, këto ndërmarrje u shpërbënë në disa grupe gjyete, të cilët nuk arrinin të siguronin të ardhura të mjaftueshme për familjet e tyre. Duke qenë në kushte të filla, ata vlerësuan nevojën për bashkëpunim prandaj u rigrupuan dhe në 05.05.2003 krijuan OMP Liqeni i Shkodrës (dhe më 09.09.2021 u regjistrua në regjistrin themeltar të OJF-ve), si e vetmja organizatë që përfaqëson peshkimin ose e thënë ndryshe, kooperativa e peshkatarëve.

Gjatë më shumë se 30 viteve ndryshim në stil dhe në material peshkimi, përveç fitimeve nga peshkimi, kishte dhe humbje në materiale, pasi Liqeni i Shkodrës është një liqen relativisht i cekët. Peshkatarët, të shtyrë nga nevojat e tyre ekonomike për të zënë sa më shumë peshk, i hidhnin rrjetat në kohë të qëndrueshme dhe të paqëndrueshme. Për

<sup>5</sup> <https://www.bashkiashkoder.gov.al/>

pasojë, shumë nga këto rrjeta nuk gjendeshin më apo edhe kur gjendeshin ato nuk u interesonin më peshkatarëve pasi ishin në gjendje të keqe. Këtu zë zanafillë edhe procesi i rrezikshëm i cili u trajtua nga projekti. Këto rrjeta nuk funksiononin në të gjithë gjatësinë e tyre, por kishte pjesë që ato vazhdonin të kryenin gjueti peshku të rënë në to, peshk që nuk merrej nga peshkatarët duke i dhënë udhë procesit të dekompozimit të peshqve në rrjeta. Këto me kalimin e kohës ishin kthyer në një burim të rrezikshëm infeksioni apo epidemish, pasi në Liqenin e Shkodrës nuk ka peshq grabitqarë. Nga ana tjetër këto rrjeta nuk ishin vetëm burim infeksioni, por edhe një rrezik për vetë peshkatarët, pasi gjatë lundrimit me mot të keq, ato kapen në helikat e motorëve (duke i bllokuar motorët) dhe shndërrohen në burim incidentesh, të ndodhura më shumë se një herë. Një problematikë tjetër paraqitet me shpendët shtegtues apo dhe ata autoktonë të cilët bëjnë pasazhin në Liqenin e Shkodrës. Ata kanë qenë shpesh pre e këtyre rrjetave. Të gjitha këto problematika të krijuara nga rrjetat e braktisura kanë ndikuar drejtpërdrejt në cilësinë e ujit dhe ajrit.

#### 4.2.2 PËRSHKRIMI I ÇËSHTJES SË TRAJTUAR

Përgjatë periudhës 01.11.2021 – 30.06.2022, OMP Liqeni i Shkodrës zbatoi projektin "Pastrimi i mjedisit të Liqenit të Shkodrës nga rrjetat e braktisura", i cili kishte si objektiv të përgjithshëm pastrimin e liqenit nga rrjetat e braktisura dhe ndalimin e peshkimit fantazmë me qëllim ruajtjen e biodiversitetit të liqenit, specieve ujore që e popullojnë dhe të mbrojtjes së jetës së peshkatarëve, si dhe rritjen e ndërgjegjësimit të komunitetit të peshkatarëve dhe të grupeve të interesit për sa i takon rëndësisë që ka mbrojtja e mjedisit për komunitetin.

Projekti, pas një analize të detajuar të situatës e problematikave të paraqitura në seksionin paraardhës, u konceptua për të arritur rezultate të prekshme si për sa i takon informimit dhe ndërgjegjësimit të komunitetit të peshkatarëve dhe të rinjve e komunitetit përreth, ashtu edhe për të ndërmarrë veprime konkrete dhe me ndikim në fushën e mjedisit përmes aksionit të pastrimit të rrjetave të braktisura.

Në fazën e parë të tij, për vetë dinamikën që kishte projekti, karakteri ishte më shumë ndërgjegjësues dhe informues për situatën e Liqenit të Shkodrës dhe për rëndësinë e pastrimit të tij nga këto rrjeta. Më pas, aktivitetet u përqendruan në përbërës teknik, ku vëmendjen kryesore e patën trajnimet me peshkatarët, me të cilët u zhvilluan tre sesione trajnimi teorik dhe 5 ditë trajnimi në terren për evidentimin e zonave problematike. Gjithashtu, u siguroa pajisja me materialet e nevojshme për përcaktimin e zonave dhe pastrimin e tyre. Në tre sesionet e trajnimit teorik morën pjesë 60 persona nga komuniteti i peshkatarëve. Pjesëmarrës pati edhe nga Universiteti i Shkodrës "Luigj Gurakuqi", si dhe nga Sektori i Inspektoratit të Peshkimit apo nga DSHPA.

Përfshirja e grupeve të ndryshme rezultoi interesante pasi çështjet u diskutuan e trajtuan nga këndvështrime të ndryshme dhe pjesëmarrësit e kuptuan rëndësinë që ka

bashkëpunimi, partneriteti dhe përfshirja e aktorëve të ndryshëm për të gjetur zgjidhje për një qëllim të përbashkët, pastrimin e mbrojtjen e mjedisit.

Figura 17. Trajnimet me peshkatarët



Përveç trajnimeve me komunitetin e peshkatarëve, u zhvilluan edhe dy sesione trajnimi me nxënësit e shkollave 9-vjeçare "Ernest Koliqi" në Shirokë dhe "Prek Gjoni" në Bajzë (Malësi e Madhe), që ishin dhe zonat kryesore në vëmendje të projektit, me qëllim informimin dhe ndërgjegjësimin e këtyre nxënësve dhe të rinjve për vlerën e mbrojtjes së mjedisit dhe biodiversitetit, gjatë të cilave morën pjesë 48 të rinj (26 vajza/gra dhe 22 djem/burra). Përfshirja e nxënësve është një vlerë e shtuar, jo vetëm për ndërgjegjësimin e informimin e tyre, por edhe për diskutimin mbi zgjidhje krijuese të problematikave konkrete mjedisore që shqetësojnë komunitetin.

Figura 18. Trajnimet me nxënësit e shkollave 9-vjeçare në Shirokë & Bajzë, Malësi e Madhe



Faza finale e projektit u fokusua në përcaktimin e zonave problematike, ku u evidentuan për pastrim ajo e Fushë-Bunës në Shirokë dhe ajo Kamicë, Flakë-Kosan & Shegan, për të vijuar më pas me aksionin e pastrimit në ujërat e Liqenit të Shkodrës.

Figura 19. Procesi i pastrimit nga rrjetat e braktisura



U caktuan zona me thellësi të vogël ku si rrezikshmëria, edhe interesi i peshkatarëve më i madh është më i madh. Për aktivitetin e pastrimit të liqenit nga rrjetat, u përzgjodhën 10 peshkatarë. Këta ishin edhe pjesë e sesioneve teorike të zhvilluara në fazën e parë të projektit. Në zonën Kamicë – Flakë – Kosan – Shegan pastrimi zgjati 19 ditë, ndërsa në zonën e Fushë-Bunës 15 ditë. U pastruan rreth 44 km<sup>2</sup> ujëra të Liqenit të Shkodrës nga rrjetat e braktisura dhe u hoqën rreth 116 km rrjeta të mbetura në ujëra për arsye të ndryshme. Bashkitë e Shkodrës dhe të Malësisë së Madhe ndihmuan me transportin e këtyre rrjetave për në landfill.

Edhe pse një projekt i vogël, me ndërhyrje të thjeshta për pastrimin e rrjetave, kjo nismë pati një rëndësi të veçantë për mbrojtjen e biodiversitetit dhe të mjedisit ujor dhe të sigurisë së peshkatarëve, përmes të cilit u arrit jo vetëm të rritej shkalla e informimit dhe e ndërgjegjësimit, por edhe të ngjallej interesi për peshkimin me përgjegjshmëri për mbrojtjen e mjedisit dhe ruajtjen e habitatit, në përputhje me objektivin kryesor të projektit. E një rëndësie të veçantë ishte edhe mbështetja që i dha projektit komuniteti i peshkatarëve dhe ai i banorëve që jetojnë përreth liqenit në pjesëmarrje, por edhe nëpërmjet angazhimit në pastrim.

Përfshirja e komunitetit lokal u konsiderua një element kyç për qëndrueshmërinë e objektivave të projektit pasi ndërgjegjësimi i tyre ndikon në të ardhmen në vendimmarrje me qëllim ruajtjen e mjedisit, duke përshtatur praktika peshkimi të qëndrueshme dhe duke promovuar modele të qëndrueshme biznesi.

Figura 20. Peshkimi si burim kryesor të ardhurash për familjet



Një numër i konsiderueshëm përfituesish u përfshinë përmes këtij projekti. Rreth 50 peshkatarë, 48 nxënës dhe banorë të zonës së synuar u përfshinë në aktivitetet e projektit përmes takimeve dhe trajnimeve të zhvilluara, të cilat u shtrinë nga Shiroka deri tek Syri i Sheganit.

Përfshirja dhe angazhimi i peshkatarëve në sesionet teorike dhe ato praktike të zhvilluara gjatë zbatimit të projektit ishte një rezultat i rëndësishëm i arritur jo vetëm në terma ndërgjegjësimi, por edhe ndërmarrje veprimesh, që mund të vijojnë edhe pas përfundimit të projektit, me vullnet, angazhim qytetar dhe mundësi financimi. Kjo do të bëjë të mundur edhe pastrimin e zonave të tjera problematike dhe do të ndihmojë në parandalimin e dëmeve të mëtejshme.

Gjithashtu, të rëndësishme për qëndrueshmërinë e rezultateve të arritura ishin edhe trajnimet e zhvilluara me të rinjtë (nxënësit) e zonave të synuara, të cilët mund të përçojnë informacionin me tej, tek bashkëmoshatarët, familjet dhe komuniteti përreth. Përfshirja e të rinjve të shkollave konsiderohet një vlerë e shtuar, pasi trajnimet me të rinjtë nuk ishin parashikuar në projekt-propozim, por që u vlerësuan të një rëndësie të veçantë, për të krijuar një proces gjithëpërfshirës si dhe duke pasur parasysh se ata mund të luajnë një rol të rëndësishëm për mbrojtjen e mjedisit.

Përmes pastrimit të 44 km<sup>2</sup> të sipërfaqes së Liqenit të Shkodrës që është pothuaj 1/3 e sipërfaqes së këtij liqeni (pjesa shqiptare) është arritur largimi nga ujërat e liqenit të 116 km rrjeta të braktisura, rritja e sigurisë së lundrimit në këto zona të pastruara, cilësia e ujërave, cilësia e ajrit, parandalimi i sëmundjeve tek peshqit, sigurimi i një zone të sigurt për zogjtë etj.

#### 4.2.3 PËRFUNDIME

- Në Liqenin e Shkodrës, përveç dy zonave të përzgjedhura nga projekti, ato të Fushë-Bunës & Kamicë, Flakë, Kosan dhe Shegan, të cilat u pastruan përmes ndërhyrjeve të parashikuara nga projekti, gjenden ende shumë rrjeta të braktisura.
- Peshkatarët që u trajnuan dhe ata që nuk patën mundësi të merrnin pjesë, duhet të jenë të kujdesshëm për të mos lënë rrjeta në ujërat e liqenit. Nëpërmjet trajnimit ata u ndërgjegjësuar mbi dëmet që ato sjellin në ekosistemin e liqenit dhe në mjedis, si edhe në sigurinë e jetës së tyre.
- Pastrimi i rrjetave të braktisura ndihmoi në përmirësimin dhe pastrimin e ekosistemit ujor.
- Pastrimi i rrjetave në liqen solli lëvizje më të sigurt të vetë peshkatarëve gjatë kryerjes së aktivitetit të peshkimit.
- Gjatë zhvillimit të projektit, u krijuan ura bashkëpunimi me institucionet vendore, si Bashkia Shkodër dhe bashkia Malësi e Madhe, si edhe me AdZM Shkodër, peshkatarët e zonës, shkollat dhe komunitetet.
- Përfshirja e brezit të ri të nxënësve të shkollave ishte një nga risitë që projekti mundësoi, duke rritur ndërgjegjësimin e tyre mbi rëndësinë që ka mbrojtja e biodiversitetit të liqenit. Nëpërmjet këtij aktiviteti i krijuan ura bashkëpunimi me stafet drejtuese të dy shkollave të përfshira (Shirokë dhe Bajzë), me nxënësit e këtyre shkollave si pjesëtarë të komunitetit por edhe, për disa pre tyre, si pjesë e familjeve që ushtrojnë peshkimin.
- Bashkëpunimi me komunitetet që banojnë rreth brigjeve të liqenit ishte i rëndësishëm dhe një tjetër risi që solli projekti, duke rritur vetëdijen por edhe angazhimin qytetar në nisma për mbrojtjen e mjedisit.

#### 4.2.4 SUGJERIME

- 1) Aksionet e pastrimit të rjetave duhet të përfshihen në metodologjinë e punës së instancave përkatëse për t'u kryer në mënyrë periodike.
- 2) Duhet të ketë mesazhe ndërgjegjësuese për mbrojtjen e ujërave të liqenit nga të gjithë aktorët e përfshirë në menaxhimin e tij, përfshirë edhe bizneset e zonës.
- 3) Trajnimet me peshkatarët duhet të jenë të vazhdueshme në mënyrë që të minimizohet ndikimi negativ i peshkimit në biodiversitetin e liqenit.
- 4) Ka nevojë për koordinim më të mirë ndërmjet autoriteteve menaxhuese si AdZM/bashki/shoqata peshkatarësh, etj.
- 5) Përfshirja e komunitetit dhe e studentëve në aksionet e pastrimit do të ishte vlerë e shtuar pasi do të forconte lidhjen e tyre me këtë pasuri natyrore.
- 6) Promovimi i peshkimit të qëndrueshëm si një praktikë e mirë për ruajtjen e habitatit të Liqenit të Shkodrës.
- 7) Zhvillimi i aktiviteteve promovuese duke angazhuar komunitetin (ka plot njerëz që kanë dëshirë dhe kërkojnë të angazhohen) në aksionet e peshkimit.

#### 4.3 PROJEKTI: TË RINJTË SHKODRANË KUNDËR HUMBJEVE USHQIMORE

**Organizata zbatuese:** *Well-Point - Kujdes për të gjithë*

**Bashkia/NjA:** Shkodër

##### 4.3.1 SFONDI I ÇËSHTJES

Një e treta e ushqimit të prodhuar për konsum njerëzor shkon dëm. Sipas FAO (2023), afërsisht 14% e ushqimit në nivel global, me vlerë prej 400 miliard USD humbin çdo vit në procese mes të korrave dhe tregut me pakicë, ndërkohë që 17% e ushqimit humbet në procese nga shitja me pakicë te konsumatori. Ky është një problem social e moral, i cili ndikon në shtresa të ndryshme të shoqërisë e për rrjedhojë një pjesë e ushqimit, i cili nuk shfrytëzohet nga disa persona apo kompani, mund të përdoret për të ndihmuar shtresat në nevojë duke ulur sasinë e ushqimeve që shpërdorohen e në këtë mënyrë, duke ulur sasinë e ushqimit që kthehet në mbetje. Prandaj, ulja e humbjeve të ushqimit është një objektiv shumë i rëndësishëm drejt përmirësimit të sigurisë ushqimore, cilësisë e qëndrueshmërisë dhe rritjes së efektivitetit.

Përtej fenomenit social qëndron edhe ai mjedisor, ku sipas studimeve të ndryshme, ushqimi i çuar dëm (ose mbetjet ushqimore) është përgjegjës për mbi 8 – 10% të gazeve serë që emetohen në atmosferë (FAO, 2023).

Shifrat janë domethënëse: nëse mbetjet ushqimore do të ishin një shtet, ai do të ishte shteti i tretë në botë për sa i përket emetimeve të gazeve të dëmshme në atmosferë. Karboni total i emtuar nga mbetjet ushqimore llogaritet në 3.3 miliardë tonë në vit. Nga ana tjetër, ndikimet në mjedis lidhen edhe nëpërmjet sektorëve të tjerë siç është ai bujqësor, ku sipas studimeve përlllogaritet se, një e katërta e ujit që përdoret në sektorin

bujqësor, shërben për të prodhuar produkte të cilat nuk do të konsumohen kurrë. Kësisoj, eliminimi i humbjeve si dhe mbetjeve ushqimore do të ndikonte në uljen e emetimeve të dëmshme duke ulur ndikimin në klimë si dhe ruajtjen e burimeve ujore (FAO, 2023).

Raporti i Indeksit të Mbetjeve Ushqimore 2021 evidenton se: *“Mbetjet ushqimore janë një problem jo vetëm i vendeve të zhvilluara por një çështje globale. Në Europë, çdo njeri është përgjegjës për rreth 100 kg ushqim të çuar dëm. Mbetjet ushqimore në Shqipëri vlerësohen në rreth 83 kg/person/vit”* (Environment, 2021).

Kuadri politik ligjor shqiptar mbi menaxhimin e mbetjeve i kushton pak vëmendje parandalimit të gjenerimit të mbetjeve organike apo atyre ushqimore. Në dokumentin e Politikave Strategjike dhe Planit Kombëtar të Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve 2020 – 2035 (Planifikimi, 2020), miratuar me vendim nr. 418 datë 27.05.2020, parashikohet se: *“Do të merren masa për nxitjen e grumbullimit të ndarë të materialeve të riciklueshme në zonat urbane dhe menaxhimin e ndarë të mbetjeve organike në zonat rurale. Do të nxitet kompostimi i decentralizuar dhe kompostimi në kushtet e shtëpisë në zonat rurale”*. Dokumenti shprehet se do të ketë ndarje në burim të mbetjeve, të cilat përfshijnë mbetjet organike edhe në shkolla e mjedise publike. Nga ana tjetër, ky dokument nuk jep afate se kur do të realizohen ato.

Është për t'u theksuar gjithashtu se dokumenti nuk parashikon asnjë praktikë mbi menaxhimin e tepricave ushqimore, se si ushqimi të mos kthehet në mbetje por ta ridrejtojmë tek shtresat në nevojë për sa kohë është ende cilësor për konsum.

Gjithashtu, edhe Organizata e Kombeve të Bashkuara për Ushqimin dhe Bujqësinë FAO (2019), ka bërë një sërë sugjerimesh për Qeverinë Shqiptare për përfshirjen e mbetjeve dhe humbjeve ushqimore në planifikimin strategjik (faqe 10, *output 2.3, target 2*)<sup>6</sup>.

Në vendet e tjera të rajonit, nuk ka një ligj apo praktikë *one-fits-all* dhe në secilin vend, praktikat ligjore që nxisin dhurimet ushqimore apo menaxhimin e mbetjeve janë të ndryshme sipas legjislacionit përkatës.

Disa mënyra të ndërhyrjeve ligjore do të përfshinin: nxitjet në taksa të cilat mund të ulin deri në zero nivelin e TVSH-së, ulja e sasisë së produkteve të dhuruara nga xhiroja vjetore e biznesit me qëllim uljen e taksave vjetore, rritja e cilësisë dhe kërkesave që sigurojnë produkte më jetëgjatë dhe kësisoj më pak mbetje, etj.

Në këtë kuadër, duke ditur edhe rritjen e presionit ndërkombëtar ndaj çështjeve të mjedisit, gjykojmë se, shumë shpejt, në vendin tonë, Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm (OZHQ) do të monitorohen me kujdes. Kështu, OZHQ 12.2, 12.3 dhe ai 13<sup>7</sup> lidhen direkt me fushën e projektit të zbatuar.

<sup>6</sup> <https://www.fao.org/3/ca8216en/CA8216EN.pdf>

<sup>7</sup> <https://albania.un.org/sq/sdgs>



Të tilla ndërhyrje ligjore mund të kenë një ndikim shumë të madh në sasinë e mbetjeve që depozitohen në landfill, nivelin e gazeve serë të cilat çlirohen në ajër, sasinë e ushqimit që rishpërndahet në shtresat në nevojë e ato të marginalizuara, etj.

#### 4.3.2 PËRSHKRIMI I ÇËSHTJES SË TRAJTUAR

Projekti i zbatuar nga *Well-Point* kishte si synim përfshirjen e rreth 50-60 të rinjve në qytetin e Shkodrës, të rinj që vinin nga tre grupe të ndryshme: a. Grupi joformal 'Naturalistët', b. një përfaqësi e Shkollës së Mesme Profesionale "Hamdi Bushati" dhe c. një përfaqësi e Shkollës 9-vjeçare "Dëshmorët e Rrencit". Projekti kishte si qëllim trajnimin e tyre mbi efektet që ka hedhja e ushqimit në mjedis si dhe u përpoq, nëpërmjet aktiviteteve të vizibilitetit, të nxisë ndërgjegjësimin publik mbi efektet e mbetjeve ushqimore në jetën tonë.

Projekti u ideua që t'i jepte secilit prej tre grupeve të të rinjve një pamje të qartë të çështjes së mbetjeve ushqimore dhe ndikimin e tyre, vendet kryesore ku ato krijohen, praktikat se si mund të rikuperohen tepricat ushqimore duke përfshirë edhe konceptin e dhurimit si dhe, në përfundim, si një hallkë e cila nuk mund të shmanget, se si të kompostohen mbetjet ushqimore si mënyra më e mirë për trajtimin e tyre për të kryer mbylljen e ciklit të ushqimeve.

Projekti ndoqi një sërë praktikash për ta bërë më të thjeshtë përfshirjen e grupeve të ndryshme të interesit të tilla si: a. edukimin në klasë për t'u shpjeguar të rinjve të përfshirë në teori problematikat dhe zgjidhjet, b. demonstrimet në praktikë të cilat u zhvilluan në një tokë e cila u përdor si laborator e simuloi një landfill të vërtetë, c. takime me tregtarë tek tregjet e fruta-perimeve si dhe d. aktivitete sociale në qendrat sociale të qytetit në mënyrë që të ndikojë në ritjen e ndërveprimit mes të rinjve të përfshirë.

Figura 21. Pamje nga aktivitetet e projektit



Grupi i punës e nisi këtë projekt me një trajnim teorik të të tre grupeve të të rinjve me materiale cilësore mbi mbetjet ushqimore.

Figura 22. Pamje nga trajnimi për mbetjet ushqimore



Më pas, projekti vijoi me aktivitete praktike të zhvilluara në një hapësirë të marrë në përdorim me anë të demonstrimeve mbi mënyrën e kalbëzimit, dekompozimit e ushqimeve apo paketimit të tyre. Toka u nda në tre seksione të caktuara sipas secilit grup pjesëmarrës. U simulua një landfill i vërtetë me anë të kompostimit të ushqimeve dhe sendeve të tjera jo-organike. Të rinjtë mësuuan praktikatat e kompostimit, cilat janë produktet të cilat nuk mund të kompostohen në kushte shtëpie dhe vlerat që ka kompostimi në mjedis. Ata panë ndryshimin në cilësinë e dheut për shkak të plehërimit, si dhe panë edhe ndikimin negativ të mbetjeve jo-organike në mjedis, si p.sh. të mbetjeve plastike.

Ky aktivitet solli shumë qartësi tek të rinjtë se si koha ndikon në dekompozim dhe se çfarë ndikimi real ka në mjedis kjo 'çuarje dëm' dhe groposje e ushqimeve. Ky aktivitet në terren la gjurmë në mendjen e të rinjve, të cilët u përfshinë vetë praktikisht në këtë punë.

Një lloj i tretë aktiviteti ishte marrja e ushqimit nga tregtarët në tregjet e fruta-perimeve nga secili grupim i të rinjve si dhe dërgimi i tij në qendrat komunitare të qytetit të Shkodrës. Të rinjtë, me anë të këtij aktiviteti, përforcuan bindjen që jo vetëm që ka shumë ushqim i cili hidhet (pohuar kjo nga tregtarët), por edhe se tregtarët janë të gatshëm të dhurojnë tepricat e ushqimit që nuk shitet për familjet në nevojë. Qëllimi kryesor i këtij aktiviteti, nuk ishte në vetvete ndihma me ushqim për familjet në nevojë të zonës, por së pari krijimi i botëkuptimit të duhur të të rinjve se ka shumë ushqim i cili shkon dëm ndërkohë që mund të rikuperohet dhe, se, në rast se krijohen kushtet e duhura dhe ata janë të angazhuar, mund të shpëtojnë një sasi e konsiderueshme ushqimi nga të shkuarit dëm, duke ndotur mjedisin.

Figura 23. Voza rrotulluese



Përveç të tjerave, të rinjtë u prezantuan me vozën rrotulluese (foto në krah) e cila është një pajisje e thjeshtë, e mbajtshme dhe e lirë e cila mund të përdoret kudo për kompostim dhe nxjerrje plehu cilësor dhe organik. Voza rrotulluese, një model i përdorur gjatë projektit, përveçse iu prezantua të rinjve, gjithashtu iu dhurua Shkollës "Hamdi Bushati" për ta ekspozuar në mjediset e saj si nxitje për të rinjtë e kësaj shkolle që të fillojnë vetë të kompostojnë gjatë praktikave mësimore. Në fakt, të gjitha shkollat të cilat kanë një oborr, kanë hapësirë mjaftueshëm për të kompostuar me anë të vozës rrotulluese.

Kjo është një mënyrë e thjeshtë edukuese për të rinjtë për menaxhimin e duhur të mbetjeve të tyre gjatë periudhës që janë në shkollë.

Projekti zhvilloi edhe një vizitë shtesë në landfillin e Bushatit, ku u tregua nga afër trajtimi i mbetjeve bashkiake dhe ushqimore të zonës Shkodër dhe Lezhë si dhe u morën informacione se sa dhe si ndikohet mjedisi i zonës përreth nga ky impiant trajtimi mbetjesh.

Projekti u shoqërua me materiale profesionale në gjuhën shqipe (duke u bazuar, tek materialet e FAO UN, 9 Këshilla të thjeshta, *Do Good, Save Food*). Ky material përfshin

kërkim dhe informacione statistikore mbi mbetjet ushqimore si dhe trajnim mbi këshilla të përditshme se si të ulim sasinë e mbetjeve ushqimore.

Figura 3. Vizita në landfillin e Bushatit



Ndër të tjera, projekti zhvilloi edhe një aktivitet me të rinjtë për shpërndarjen e fletushkave mbi mbetjet ushqimore në qytet për të ndërgjegjësuar komunitetin e këtij qyteti mbi praktikatat e rikuperimit të këtyre produkteve.

Një nga përfitimet kryesore të projektit ishte nxitja e të rinjve për të menduar në mënyrë kritike dhe aftësimi i tyre për të gjetur zgjidhje për problemin e mbetjeve ushqimore në mjedis. Me anë të projektit, këta të rinj mprehën aftësitë e tyre ndër-personale, duke biseduar me tregtarët, fermerët dhe familjet në nevojë të zonës.

#### 4.3.3 PËRFUNDIME

- Në Shqipëri ka shumë pak ose aspak nisma lokale që nxisin menaxhimin e tepërcave ushqimore sipas piramidës së trajtimit të mbetjeve.
- Të rinjtë shprehin gatishmërinë e tyre për t'u përfshirë në nisma të ngjashme. Vërehet nevoja për t'u mësuar atyre pavarësinë në të menduar dhe në dhënien e kontributit. Në këtë drejtim, bashkëpunimi i vazhdueshëm me bashkinë e Shkodrës do të ishte një vlerë e shtuar.
- Referuar kërkimeve dhe punës në terren në këtë projekt, vendi me mundësi më të lartë të gjenerimit të mbetjeve ushqimore është tregu i qytetit Shkodër.
- Vendosja e linjave të bashkëpunimit ndërmjet bizneseve, tregtarëve, shoqërisë civile, komunitetit dhe bashkisë Shkodër për shpërndarjen e tepërcave ushqimore në qendra komunitare apo tek shtresat në nevojë.
- Menaxhimi i FLW<sup>8</sup> duhet të jetë një komponent i rëndësishëm i luftës kundër mbetjeve në vend.

<sup>8</sup> Food Loss and Waste – Hedhjet dhe humbjet ushqimore

- Aktualisht, në Shqipëri nuk ka ligje të cilat rregullojnë tepricat ushqimore në mënyrë specifike, por vetëm një përafrim të dokumenteve strategjike mbi menaxhimin e mbetjeve urbane e atyre organike me legjislacionet e vendeve të tjera. Ndërthurjet e duhura të legjislacionit me praktikën e sugjeruara mund të kenë ndikim shumë të madh në nivelin e mbetjeve që depozitohen në landfill, nivelin e gazeve serë të cilat çlirohen në ajër, sasinë e ushqimit që rishpërndahet në shtresat e margjinalizuara, etj.
- Përfshirja e praktikave mësimore, të cilat ilustronë e flasin për praktikën e kompostimit dhe hapat që mund të ndërmerren për parandalimin e gjenerimit të mbetjeve ushqimore në shkollë, do të shërbenin si një model nxitës për të rinjtë.
- Nga vëzhgimet në terren është parë se pjesa më e madhe e shkollave në bashkinë Shkodër kanë një oborr me hapësirë të gjerë në territorin e tyre e për rrjedhojë mund të merret në konsideratë instalimi i vozave rrotulluese për të bërë procesin e kompostimit të mbetjeve ushqimore të nxënësve gjatë kohës që shpenzojnë në shkollë. Instalimi i vozave në shkollë do të kishte përfitime edukuese pasi mund të zhvillohen praktika mësimore me shembuj konkretë si dhe mund të gjenerohen përfitime ekonomike nga shitja e plehut organik të krijuar nga procesi i kompostimit. Të ardhurat mund të përdoren për të pasuruar bibliotekën e shkollës ose për të blerë materiale mësimore, etj.
- *Savefood.al* është një platformë e cila po ndërtohet nga "Feeding Albania" dhe do të shërbejë për edukimin dhe ndërgjegjësimin e komunitetit mbi parandalimin e gjenerimit të mbetjeve ushqimore.

#### 4.3.4 GJETJE NGA BASHKIA SHKODËR

- Në Shkodër nuk ka nisma specifike qytetare dhe as të pushtetit lokal mbi mbetjet ushqimore dhe ndikimin e tyre në mjedis. Shërbimet e mbrojtjes së mjedisit të bashkisë Shkodër nuk kanë ndonjë program ndërgjegjësimi mbi parandalimin e mbetjeve ushqimore.
- Menaxhimi i mbetjeve urbane pranon landfillin si të vetmin institucion që i trajton mbetjet ushqimore.
- Sipas planit lokal të menaxhimit të mbetjeve dhe të dhënave nga terreni, mbetjet organike llogariten në rreth 45 – 50% të totalit të mbetjeve që krijon bashkia dhe që depozitohen në landfillin e Bushatit.
- Bashkia e Shkodrës është duke hartuar një plan për njësinë administrative të Velipojës për riciklimin e mbetjeve gjatë sezonit turistik veror, për t'i ndarë ato në burim. Kjo nismë duhet mbështetur si dhe duhet parë mundësia për të përfshirë aty praktikën e kompostimit.

#### 4.3.5 GJETJE NGA TREGJET E FRUTA-PERIMEVE TË ZONËS SË SHKODRËS

- Tregtarët e shumicës së fruta-perimeve konfirmuan se nga volumi i produkteve ushqimore që ata blejnë nga prodhuesit e fruta-perimeve, të cilin më pas ua shesin blerësve familjarë, së paku 30 – 40% nuk arrijnë të shiten.

- Sipas tregtarëve, niveli i jetesës përcakton shumë se sa njerëzit konsumojnë, sidomos në muajt e ftohtë të vitit kur çmimet janë më të larta. E thënë ndryshe, çmimet më të shtrenjta të fruta-perimeve gjatë stinës së dimrit bëjnë që të ketë më pak shitje, duke qenë se vetëm një pjesë e familjeve mund t'i përballojnë ato.
- Të gjitha mbetjet ushqimore hidhen në koshat publikë e më tej në landfillin e Bushatit. Nuk ka ndarje specifike në burim dhe, shpesh, mbetjet janë burim për ndotje dhe erë të rëndë në komunitet, edhe pse ato pastrohen çdo ditë.
- Përgjithësisht, të rinjtë kanë shumë pak informacion mbi trajtimin e mbetjeve ushqimore dhe se si ato ndikojnë në jetën tonë. Gjithashtu, ata nuk kanë informacion mbi ndikimin e mbetjeve në ndryshimet klimatike.

#### 4.3.6 GJETJE NGA TOKA LABORATOR


- Kompostimi i mbetjeve organike është imitim i procesit natyror të dekompozimit dhe ristrukturimit të lëndës së gjallë (organike). Ai e ndihmon natyrën të rigjenerohet. Në Shqipëri, kompostimi është në fazat e para për sa i përket edukimit masiv qytetar.
- Përgjithësisht, të rinjtë, nuk marrin edukim në shkollë mbi mbetjet ushqimore apo kompostimin e tyre.
- Nëse ndiqen rregullat, duhen 2 – 3 muaj që të sigurohet pleh cilësor nga mbetjet.
- Hedhja e ushqimit me paketim të mbyllur nuk e shpërbën ushqimin. Paketimi e transformon ushqimin në lëndë helmuese për tokën dhe sjell kompostim anaerobik. Gjithashtu, paketimi duhet të riciklohet.
- Kompostimi në kushtet e shtëpisë, shkollës apo zyrës është i mundur dhe i lehtë (p.sh., me anë të vozës rrotulluese).
- Edukimi në këtë fushë mbetet kyç dhe projekti ishte nxori qartazi në pah mungesën e vëmendjes ndaj mbetjeve ushqimore. Mund të përdoren materiale edukuese në shqip si piramida e trajtimit të ushqimit si dhe materiale të tjera edukuese nga "Feeding Albania".

#### 4.3.7 SUGJERIME

1. Tepricat ushqimore nuk janë humbje por, të përdorura në mënyrën e duhur mund të kthehen në një burim ekonomik. Në këtë aspekt, ekonomia qarkulluese promovon përdorimin sa më të mirë të burimeve të kufizuara dhe çdo përmirësim në fushën e trajtimit të tepricave ushqimore sjell praktika efektive që ndikojnë në mbrojtjen e ekonomisë. Në këtë kuadër, duke iu referuar edhe INSTAT (Papunësia, 2021), sipas së cilit shkalla e papunësisë në Shkodër është rreth 39%, në këtë zonë, por edhe në të tjera zona periferike të vendit ku ka të ardhura të pakta apo papunësi të lartë, rishpërndarja e tepricës ushqimore do të ishte një amortizator i mirë për problemet e tyre sociale.
2. Projekti nxori në pah se mbetjet ushqimore prodhojnë gaz metan dhe karbonik, të cilët sjellin erë të keqe, janë gaze serë që ndikojnë në ndotjen atmosferike si dhe

- zënë vend në landfill. Të dhënat thonë se 1 kg mbetje ushqimore është mesatarisht përgjegjëse për 2 kg karbon shtesë në atmosferë (Waste, 2013).
- Gjatë projektit, u verifikua se produktet ushqimore dekompozohen në shpejtësi të ndryshme në varësi të llojit të produkteve dhe përbërjes së masës për t'u kthyer në pleh. Po ashtu, paketimi ndikon në mënyrë masive. Sugjerohet që ushqimi të hiqet nga paketimi, sidomos nga ai plastik dhe pastaj të hidhet në masën për dekompozim.
  - Metoda kryesore e përdorur nga projekti për të shpëtuar ushqimin e hedhur dëm, ishte marrja e dhurimeve të tepërta ushqimore nga tregtarët lokalë, ushqim që u shpëtua nga kalbja dhe kësaj u shmang edhe emetimi i karbonit. Gjithashtu, u shpjegua piramida e mbetjeve ushqimore, u zbatuan praktika specifike kompostimi në terren duke përfshirë vozën rrotulluese të kompostimit si dhe u demonstruan praktikatat e landfilleve për menaxhimin e mbetjeve ushqimore.

Figura 25. Piramida ushqimore



Burimi: <https://foodbank.al/urica-dhe-mbetjet-ushqimore/piramida-ushqimore/>

Bazuar në këto studime, sugjerohet që në të gjitha qytetet në Shqipëri ku ka tregje fruta-perimesh, tregje të cilat sjellin shumë mbetje ushqimore, të krijohen kapacitetet për ridrejtim të tyre tek shtresat në nevojë kur këto ushqime janë ende të mira për konsum. Së dyti, të sigurohet mundësia që ushqimi i tepërt i këtyre tregjeve të ndjekë piramidën e mbetjeve ushqimore duke ushqyer fillimisht kafshët, më pas të bëhet kompostimi i mbetjeve si dhe, në fund, groposja e tyre. Kjo logjikë sjell edhe mundësinë për të ricikluar paketimin e ushqimit të tepërt që përndryshe do të hidhej.

#### 4.4 PROJEKTI: LËVIZJA RINORE-QYTETI IM EKOLOGJIK

**Organizata zbatuese:** Forumi Shqiptar Liqeni i Shkodrës

**Partnerë:** Klubi Ekologjik Lezhë, Këshilli Bashkiak Shkodër, TV1-Channel, Zyra Vendore Arsimore Shkodër

**Bashkia/NjA:** Shkodër & Lezhë

##### 4.4.1 SFONDII I ÇËSHTJES

Shkodra është bashkia më e madhe për nga popullsia banuese e rajonit verior të vendit tonë. Është një prej qyteteve më të vjetra të Shqipërisë, me një histori banimi mijëra vjeçare dhe shtrihet në ultësirën perëndimore.

Shkodra është një e rëndësishme gjeostrategjike, pasi në një distancë jo më shumë se 30 km takohet me Alpet e Shqipërisë dhe detin Adriatik, Liqenin e Shkodrës dhe Basenin Drin—Bunë si dhe është pjesë e koridoreve të rëndësishme në kuadër të Ballkanit Perëndimor. Në të njëjtën kohë, Shkodra është nyja më e rëndësishme hidrografike e Shqipërisë pasi lidh ujërat sipërfaqësore të liqenit dhe lumenjve Bunë, Kir dhe Drin që shkarkohen në det përmes Deltës së Bunës.

Pasuritë e mëdha natyrore dhe biologjike, ekosistemet e ujërave të ëmbla, monumentet natyrore e kulturore, tradita dhe kultura, peizazhet dhe zonat e veçanta të trashëgimisë kulturore janë indikatorë të zhvillimit të qëndrueshëm të këtij rajoni.



Figura 26. Bashkia Shkodër sipas Njësive Administrative



Me një popullsi prej 204,954 banorë, qyteti i Shkodrës ka përqendrimin më të madh të banorëve, i cili përbën 55% të popullsisë. Aktivitetet kryesore ekonomike që kontribuojnë në zhvillimin e zonës janë kryesisht të orientuara në përpunimin dhe prodhimin e materialeve tekstile dhe industrinë së lehtë prodhuese.

Figura 27. Pamje e qytetit të Shkodrës



Shkodra njihet si zonë karakteristike prodhuese e produkteve bujqësore, blegtorale dhe agro-përpunuese. Gjithashtu, Shkodra është e njohur për praninë e bizneseve të artizanatit, të cilët kanë një traditë të vjetër në këtë qytet, duke ruajtur traditat e punimeve në dru, tekstil, qeramikë, serm, hekur, pikturë dhe pirografi. E gjithë kjo veprimtari luan një rol të veçantë në zhvillimin lokal, të ardhurat në ekonominë vendore, si dhe zhvillimin e turizmit në zonë.

Figura 28. Pika interesi të rëndësishme për zhvillimin lokal të Shkodrës



Turizmi është një nga sektorët më dinamik në bashkinë Shkodër. Me një pasuri të madhe të burimeve natyrore si Liçeni i Shkodrës, lumi Buna, laguna e Vilunit, Rezervati Natyror Velipojë etj., zona e Shkodrës është e njohur për diversitetin e pasur biologjik, trashëgiminë e saj kulturore dhe traditat e mikpritjes. Për këto arsye, tendencat e zhvillimit të turizmit kanë kurbë rritjeje. Për nga pasuria natyrore, ekosistemi Liçeni i Shkodrës–lumi Buna janë zonë e rëndësishme së veçantë ndërkombëtare dhe kanë statusin zonë “Ramsar”.

Figura 29. Rajoni i Liqenit të Shkodrës



Vitet e fundit (2018 – 2022), zhvillimi i turizmit ka njohur rritje në shifra dhe cilësi. Tashmë, mund të thuhet me siguri se turizmi është një ndër industritë kryesore të zhvillimit në bashkinë Shkodër. Statistikat zyrtare për numrin e vizitorëve që kalojnë në pikat kufitare të rajonit të Shkodrës tregojnë për një rritje prej 30% në vit për 4 vitet e fundit. Një pjesë të mirë të këtyre vizitorëve e zënë turistë që vizitojnë Shkodrën si pjesë e paketave turistike të Kroacisë dhe Malit të Zi.

Pavarësisht pasurisë natyrore, kulturore dhe historike të këtij qyteti, pas vitit 1990, ashtu si e gjithë Shqipëria, Shkodra u përball me lëvizje të mëdha demografike të qytetarëve, të cilët erdhën për të punuar e jetuar në Shkodër. Si rrjedhojë, kërkesat për shërbime, infrastrukturë, lëndë të parë dhe përdorimi i burimeve natyrore u rritën në maksimum.

Trysnia në rritje ndaj territorit urban, pyjeve dhe përdorimit të burimeve natyrore edhe sot kanë kurbë në rritje, e si rrjedhojë, reflektojnë si faktorë kërcënues të cilësisë së mjedisit. Shkarkimet e pa-trajtuara të ujërave të zeza të banorëve të bashkisë Shkodër, që derdhen në pjesën perëndimore të qytetit, aty ku liqeni takohet me lumin Buna, janë kërcënim serioz për cilësinë e jetës. KLSH, me vendim nr.19 (datë 27.03.201) ka konstatuar se: ujërat e zeza të prodhuara nga qyteti i Shkodrës shkarkohen në ujërat sipërfaqësore pa u përpunuar dhe kanë sjellë si pasojë një situatë të tejndotur në nivele të larta sëmundshmërie infektive.

Rritja e presionit ndaj zonave apo fushave bujqësore, të cilat u përdoren për ndërtime të paligjshme, sidomos në ultësirën e Shkodrës, sollën si rrjedhojë prishjen e ekuilibrave mes kërkesës dhe ofertës në bashkinë Shkodër.

Nga ana tjetër, infrastruktura e qytetit e sidomos kanalizimet e ujërave të zeza dhe atyre të përdorura ka mbetur ajo e para viteve '90, por tanimë duke i shërbyer një bashkie më të madhe e një numri më të lartë qytetarësh.

Gjendur në këtë situatë, ka një kërkesë nga ana e qytetarëve dhe e shoqërisë civile për të përmirësuar cilësinë e mjedisit përmes politikave dhe planeve të veprimtarive konkrete në nivel lokal. Natyra ka favorizuar Shkodrën me mundësi zhvillimi, ndaj grupet e interesit synojnë që Shkodra të fitojë statusin e një qyteti ekologjik, i cili do të siguronte një mjedis më cilësor për jetën humane dhe biologjike, zhvillim të qëndrueshëm për qytetin dhe rritje të ekonomisë lokale.

#### 4.4.2 PËRSHKRIMI I ÇËSHTJES SË TRAJTUAR

Nisur nga kërkesa e qytetarëve, organizatave të shoqërisë civile dhe grupeve të tjera të interesit për nxitjen e politikave mjedisore lokale dhe planifikimin e veprimtarive konkrete për përmirësimin e cilësisë së mjedisit në bashkinë Shkodër, Forumi Shqiptar Liqeni i Shkodrës (FSL) në partneritet me:

Figura 30. Lëvizja rinore - Qyteti im Ekologjik



- Këshillin Bashkiak Shkodër,
- Klubin Ekologjik Lezhë,
- Zyrën Vendore të Arsimit Shkodër dhe
- TV1Channel

nisën projektin me titull: "Lëvizja Rinore– Qyteti im Ekologjik", përmes të cilit u mbështet lëvizja e të rinjve për një qytet ekologjik me standarde mjedisore.

Projekti kishte si qëllim: nxitjen e përgjegjshmërisë mjedisore për të garantuar cilësinë e jetës humane dhe biologjike në rajonin veriperëndimor.

Përmes objektivave specifike:

- Nxitja e kreativitetit dhe angazhimi i të rinjve për mbrojtjen dhe rehabilitimin e mjedisëve natyrore.
- Vlerësimi i mundësive dhe sfidat e vizionit Shkodra Qytet Ekologjik.
- Nxitja e dialogut të politikave mjedisore me politikë-bërësit lokalë për praktika të qëndrueshme dhe mjedis të shëndetshëm për njeriun dhe pasurinë biologjike të rajonit.

Ky projekt kishte për synim të rriste vetëdijen qytetare dhe atë të autoriteteve lokale për të ndërmarrë politika dhe veprimtari lokale me ndikim pozitiv në mjedis. Kjo u bë me synim që të ulët presioni mbi shfrytëzimin e burimeve natyrore dhe aplikimin e politikave alternative për përdorimin e zgjuar të resurseve natyrore.

Në këtë drejtim, projekti zbatoi disa aktivitete, të cilat synonin grupe të ndryshme interesi, për të siguruar gjithëpërfshirje.


Projekti nisi me takimin prezantues në nivel rajonal, në të cilin u ftuan të gjithë aktorët kyç dhe përfaqësues të palëve të interesit me qëllim që të njiheshin me projektin, aktivitetet e planifikuara për t'u zhvilluar, si dhe metodologjinë e parashikuar për të realizuar secilin nga aktivitetet. Kjo qasje synonte që aktorët dhe palët e interesit të angazhoheshin dhe përfshiheshin gjatë gjithë zbatimit të këtij projekti.

Figura 31. Takimi prezantues në nivel rajoni




Pas informimit të aktorëve dhe grupeve të interesit, projekti e pa me interes marrjen e opinionit qytetar mbi cilësinë e mjedisit dhe qasjen e qytetarëve ndaj konceptit "Qytet Ekologjik".

Grafiku 4. Pyetësi online (shpërndarja)



■ Vajza/Gra ■ Djem/Burra

Grafiku 5. Pyetësi në terren (shpërndarja)



■ Vajza/Gra ■ Djem/Burra

Për këtë qëllim, projekti hartoi pyetësorë përmes të cilëve u realizua anketimi qytetar me mostër të gjerë. Gjatë një periudhe 45-ditore (nga data 15 prill e deri më 30 maj) u kryen 10 dalje në terren me 15 studentë të Universitetit të Shkodrës "Luigj Gurakuqi", të cilët u angazhuan në lagjet kryesore të qytetit, si: lagjja nr.1-rruga "Bulevardi Zogu I", lagjja nr.2-rruga "Lekë Dukagjini", lagjja nr.3-rruga "Marin Biçikeni", lagjja nr.4-rruga "13 Dhjetori", lagjja nr.5-rruga "3 Heronjtë", lagjja "Bahçallëk", lagjja Shirokë, lagjja Zogaj, në oraret 10:00-15:00 në mënyrë që anketimet të jenë sa më përfaqësuese. Në procesin e anketimit morën pjesë gjithsej 1,029 qytetarë, nga të cilët 515 u intervistuan ballë për ballë, ndërsa 514 *online*.


Siç shihet dhe nga grafikët e mësipërm (grafiku 4&5), pjesëmarrja e grave si në pyetësorin e shpërndarë *online*, po ashtu dhe atë të plotësuar në terren, është më e madhe (informacion që mund të përdoret gjatë përcaktimit të strategjive që mund të kenë në fokus grupe të caktuara).

Figura 32. Pamje nga anketimi qytetar



Anketimi mundësoi mbledhjen e të dhënave cilësore dhe sasiore mbi opinionet e qytetarëve të bashkisë Shkodër lidhur me standardet e elementeve në përbërje të konceptit "Qytet Ekologjik", si edhe vlerësimin e vetëdijes së qytetarëve mbi konceptin "Qytet Ekologjik". Në të njëjtën kohë, anketimi shërbeu për vlerësimin e kontributit të qytetarëve në zbatimin e objektivave ekologjike, si: riciklimi, ripërdorimi, përmirësimi i efikasitetit të energjisë në banesa, përdorimi i transportit të gjelbër, aktiviteti në natyrë, aplikimi i çatave të gjelbra, shtimi i sipërfaqeve të gjelbra, etj.


Grafiku 6. Sa njohuri keni për qytetin ekologjik?



Nga përgjigjet e dhëna prej të anketuarve, njohuritë e tyre lidhur me qytetin ekologjik janë të kufizuara gjë që tregon një nevojë të menjëhershme për ndërgjegjësimin e tyre për mjedisin dhe efektin afatshkurtër dhe afatgjatë që kanë veprimet tonë në mjedis.


Në grafikun 7, njohuritë për konceptet, shohim se konceptet si planifikim urban ripërtëritës apo parimet e zhvillimit të qëndrueshëm janë koncepte relativisht të reja, diçka që tregon domosdoshmërinë e edukimit, trajnimit, ndërgjegjësimin e bashkëpunimit me komunitetin për të rritur njohuritë në këto fusha.

Grafiku 7. Njohuritë për konceptet




Po ashtu, edhe pse hapësirat e gjelbra dhe shërbimet komunitare janë koncepte që diskutohen shpesh, siç paraqitet edhe në grafikun 8, 44% e të anketuarve nuk i njohin përfitimet e tyre.

Grafiku 8. Njohuritë që kanë të anketuarit për përfitimet nga hapësirat e gjelbra apo shërbimet e komunitetit




Për sa i përket përgjigjes lidhur me kursimin e energjisë, siç vërehet dhe nga grafikët 9 dhe 10, strategjitë më të përdorura janë përdorimi i llambave me konsum të ulët dhe i pajisjeve me efikasitet energjie.

Grafiku 9. Përpjekjet e të anketuarve për të kursyer energji në shtëpi (të anketuarit në terren)






Grafiku 10. Përpjekjet e të anketuarve për të kursyer energji në shtëpi (të anketuarit *online*)




Për t'i dhënë përgjigje pyetjes nëse banesat private kanë termoizolim apo nëse përdorin panele diellore, janë vendosur në filtër vetëm të intervistuarit që janë përgjigjur se kanë termoizolim në banesën e tyre, ndërkohë që këto të dhëna janë përpunuar më tej në raport me sa prej tyre kanë të instaluara edhe panele diellore. Rezultoi që 289 të intervistuar (28%) nga 1,029 gjithsej i kanë banesat me termoizolim dhe/ose përdorin panele diellore. Në grafikun 11 dhe 12 paraqitet shpërndarja e tyre gjeografike.

Grafiku 11. Shpërndarja gjeografike e kampionit të intervistuar që ka termoizolim (pyetësi në terren)



Grafiku 12. Shpërndarja gjeografike e kampionit të intervistuar, që ka termoizolim (pyetësori online)



Aktualisht, qyteti i Shkodrës ka sipërfaqe të gjelbër si brenda njësisë qendër, ashtu edhe në njësitë administrative, por me zhvillimin e qytetit, lind nevoja për rritjen e këtyre sipërfaqeve dhe mirëmbajtjen e tyre. Sipërfaqet e lulishteve dhe brezit të gjelbër zënë një hapësirë mbi 66,000 m<sup>2</sup>, nga të cilat 42,000 m<sup>2</sup> janë të ndriçuara, ose e thënë ndryshe, 63.6% e sipërfaqes së gjelbër është e ndriçuar. Megjithatë, 55% e qytetarëve të intervistuar mendojnë se ka “pak” hapësira argëtimi dhe të gjelbra, ndërsa 21,8% përgjigjen “aspak” (grafiku 13).


Grafiku 13. A ka hapësira të bollshme argëtimi?



Anketimi i qytetarëve u përpunua nga ekspertë të kontraktuar, të cilët hartuan analizën studimore “Vlerësimi i nevojave dhe standardeve mjedisore për një Qytet Ekologjik-Bashkia Shkodër”. Drafhti i analizës së studimit dhe gjetjet nga anketimi u konsultuan me anëtarë të Këshillit Bashkiak Shkodër, akademikë dhe studentë të Universitetit të Shkodrës “Luigj Gurakuqi”, përfaqësues të shoqërisë civile dhe të tjerë të interesuar nga komuniteti. Plani i veprimeve të analizës studimore “Potencialet dhe standardet e një Qyteti Ekologjik – Bashkia Shkodër” u mirëprit nga kryetari i bashkisë Shkodër dhe u prezantua në Këshillin Bashkiak Shkodër.

Studimi u publikua në 300 kopje, të cilat u shpërndanë për institucionet dhe aktorët kyç në bashkinë Shkodër. Studimi do të shërbejë për buxhetimin e planit të veprimeve me qëllim përmbushjen e detyrimeve të Axhendës 2030 në nivel lokal, referuar standardeve të mjedisit në bashkinë Shkodër.

Figura 33. Shpërndarja e analizës studimore



Gjatë kësaj periudhe, është punuar paralelisht me 4 gjimnazet e synuara në projekt për krijimin e parcelave të gjelbra dhe emërtimin e tyre. Nën moton “**Një parcelë–Një emër**”, në koordinim me drejtoritë e gjimnazeve të synuara në projekt, u organizua mbjellja e fidanëve pishë në malin e Taraboshit. Në bashkëpunim të ngushtë me Administratën Rajonale të Zonave të Mbrojtura në Shkodër (AdZM Shkodër) u përcaktua terreni dhe speciet e përshtatshme bimore për krijimin e parcelave me emra konkret të gjimnazeve që kontribuuan në mbjelljen e tyre.

Aktiviteti “**Një parcelë–Një emër**” mbledhi së bashku 100 të rinj e të reja, 8 specialistë të AdZM, 4 mësues dhe 4 përfaqësues të shoqërisë civile, të cilët dhanë kontribut së bashku në krijimin e parcelave të gjelbra me një numër prej 1,000 fidanësh, por që njëkohësisht

pati një ndikim të madh pozitiv në rritjen e vetëdijes së të rinjve mbi rehabilitimin e ekosistemeve dhe mbrojtjen e mjedisit, si kusht për një mjedis të shëndetshëm.

Figura 33. Aktiviteti “Një parcelë–Një emër”



Aktiviteti “Një parcelë–Një emër” mori vëmendjen e shtuar të komunitetit pasi u transmetua në kronikat informative të televizioneve lokale duke rritur ndjeshëm ndikimin e ndërgjegjësimit në komunitet.

Figura 34. Poster nga Panairi i Ideve-Qyteti im Ekologjik



Një ndër aktivitetet me ndikim të lartë vizibiliteti, ndërgjegjësimi, edukimi dhe tërheqje e vëmendjes së autoriteteve vendore ishte përgatitja dhe ekspozimi i koncepteve të gjelbra përmes konkursit: “Panairi i Ideve-Qyteti im Ekologjik”. Për të konkurruar me idetë e një qyteti ekologjik, në katër gjimnazet e synuara të këtij projekti “Jordan Misja”, “Oso Kuka”, “28 Nëntori” në Shkodër dhe “Hydajet Lezha” në Lezhë janë krijuar grupet e punës me nga 15 studentë secili, ku secili prej tyre është udhëhequr nga arkitektë dhe inxhinierë të kontraktuar nga projekti.

Për këtë qëllim, është përgatitur edhe moduli i trajnimit mbi konceptin dhe qasjen e standardeve ekologjike, i cili është shpërndarë në të katër gjimnazet konkurruese. Secili nga këto gjimnaze është udhëzuar nga mësuesit e biologjisë, të cilët janë përzgjedhur si pika kyçe për koordinimin dhe përgatitjen e të rinjve për konkursin: **“Panairi i ideve-Qyteti im Ekologjik”**.

Figura 35. Pamje nga aktivitetet e Panairit të Ideve-Qyteti im Ekologjik



Në këtë kuadër, grupi i punës organizoi një takim paraprak me kryetarin e bashkisë Shkodër me qëllim njohjen e detajuar të projektit dhe konceptin e konkurrimit të të rinjve në panairin e ideve.

Figura 36. Panairi i ideve-Qyteti im Ekologjik



Puna për përgatitjen e ideve vijoi për tre muaj me radhë. Grupet e të rinjve nga gjimnazet e synuara u pajisën me mjete dhe materiale të zgjedhura për të përgatitur punimet e tyre.

Angazhimi efektiv i të rinjve në çështjet që kërcënojnë shëndetin dhe mjedisin u finalizua me konkursin përmes të cilit të rinjtë konkurruan me ide novatore mbi menaxhimin e qëndrueshëm të burimeve natyrore të rajonit, për të arritur standardet e një qyteti ekologjik.

“Panairi i Ideve-Qyteti im Ekologjik” u mbajt në Shkodër në datë 3 nëntor 2022 ku, me anë maketeve, u prezantuan 4 ide nga secili grup. Ky panair u ndoq nga afër nga autoritete rajonale dhe vendore, donatorë, akademikë dhe artistë.

Panairi tërhoqi vëmendjen e autoriteteve dhe komunitetit pasi performanca e tij dhe risitë e sjella nga të rinjtë krijuan ndikim pozitiv për të gjithë aktorët!

Mediat vizuale transmetuan punën dhe idetë e prezantuara në panair nga të rinjtë, duke rritur vizibilitetin e këtij projekti dhe përçarur kërkesat e të rinjve për një qytet të shëndetshëm drejt një publiku më të gjerë.

Figura 37. Pamje nga aktivitetet e projektit të FSLs-së



Punimet e këtij panairi përmbushën kauzën e të rinjve për të debatuar me politikë-bërësit në nivel lokal. Të rinjtë e idesë fituese u pritën nga kryetari i bashkisë Shkodër nga i cili morën përgëzime dhe premtime për vazhdimin dhe vënien në jetë të kërkesave të tyre. Në të njëjtën kohë, ideja fituese e këtij panairi u prezantua në Këshillin Bashkiak të Bashkisë Shkodër për të marrë jetë në programet e kësaj bashkie për përmbushjen e OZhQ 2030.

Jo më pak e rëndësishme është qasja e vizibilitetit dhe mbështetjes së të rinjve në punën e tyre pas konkurrimit. Të rinjtë, fitues të konkursit “Panairi i ideve-Qyteti im Ekologjik” u ftuan në emisionin “Mirëmëngjes Shkodër” gjë e cila solli rritjen e vizibilitetit të projektit dhe rritjen e vetëdijes qytetare.

#### 4.4.3 PËRFUNDIME

- Nga anketimi i 1,029 qytetarëve u evidentua nevoja për hartimin dhe monitorimin e indikatorëve lokalë për arritjen e standardeve ekologjike.
- U konstatua se bashkia Shkodër nuk ka një plan lokal veprimi i cili vendos kritere për arritjen e objektivave, për të qenë një Qytet Ekologjik.
- Të rinjtë kanë dëshirë dhe energji për t'u përfshirë në kauza mjedisore, e në këtë drejtim, ka nevojë që ata të përfshihen më tepër nga institucionet lokale dhe shoqëria civile.
- Analiza studimore vërtetoi se vetëdija qytetare mbi treguesit dhe standardet e mjedisit është në nivele të ulëta pasi 56% e të intervistuarve (578 gjithsej) pohojnë se nuk kanë “aspak” njohuri ndërkohë që vetëm 33% e tyre (344 gjithsej) pohojnë se kanë pak njohuri.
- Bashkia Shkodër nuk ka një plan për të rinovuar ndërtesat e qytetit sipas kërkesave të nenit 9/4 të ligjit për performancën e energjisë (i cili ka hyrë në fuqi që në prill 2022) gjë që tregon mungesën e indikatorëve mjedisorë në nivel lokal.
- Të rinjtë kanë nevojë të kryejnë trajnime dhe vëzhgime në terren me qëllim që të rritin vetëbesimin në punë e të zhvillojnë ide të reja për mjedisin;
- Kauzat mjedisore në nivel rajonal janë të lidhura ngushtë me vetëdijen qytetare dhe angazhimin efektiv të grupeve të interesit;
- Gjithëpërfshirja, transparencja, kauza objektive dhe mentorimi profesional prodhojnë produkte dhe rezultate të pritshme.

#### 4.4.4 SUGJERIME

1. Hartimi dhe monitorimi i indikatorëve lokalë për arritjen e standardeve ekologjike në bashkinë Shkodër.
2. Hartimi i një plani veprimi për zbatimin e masave, kritereve dhe aktiviteteve drejt një Qyteti Ekologjik në bashkinë Shkodër.
3. Rritja e vetëdijes qytetare për monitorimin e indikatorëve të cilësisë së mjedisit në nivel lokal.
4. Pilotimi i planit lokal të veprimeve për arritjen e kritereve të një Qyteti Ekologjik në bashkinë Shkodër.
5. Rritja e kapaciteteve tematike të të rinjve në fushën e mjedisit dhe teknologjisë së informacionit për zgjidhje të qëndrueshme mjedisore.

## 5. PËRFUNDIME

Projekti “**Green-AL: Fuqizimi i organizatave të shoqërisë civile për mbrojtjen e mjedisit në Shqipëri**” i vuri vetes që në krye të herës një synim ambicioz dhe mbi të gjitha me fokus të dyfishtë:

- Nga njëra anë të kontribuojë në **fuqizimin e organizatave mjedisore**, duke punuar për përmirësimin e qëndrueshmërisë së organizative dhe profesionalizmit të tyre.
- Nga ana tjetër, **të rrisë ndikimin e aktiviteteve të lobimit dhe advokimit** në mënyrë që përmes një bashkëpunimi më të mirë ndërmjet aktorëve të shoqërisë civile, autoriteteve publike dhe sektorit privat të ndikojë në vendimmarrje brenda sferës mjedisore, me rezultate të vogla tashmë të dukshme në kuadër të projektit.

Duke qenë se projekti është në muajin e 28-të të zbatimit, u bë e mundur dalja e përfundimeve të para si në nivel projekti ashtu edhe në nivel mjedisor. Ky dokument mund të **interpretohet si një aktivitet i mëtejshëm advokues**, me qëllimin për të **ndarë praktikat e mira** në nivel kombëtar dhe për të identifikuar prioritetet, të cilat mund të adresohen në mënyrë më të shpejtë nga pushteti qendror apo vendor, nga OJF-të, nga sistemi universitar/parauniversitar, si edhe nga komunitetet lokale.

Për këtë qëllim, ky seksion përmban një përmbledhje përfundimesh të përfituara nga zbatimi i projektit nga secila nga OSHC-të. Secila prej këtyre organizatave, duke vepruar në varësi të objektivave të projektit dhe në zonën e tyre përkatëse, ka nxjerrë përfundimet e veta, të cilat në koordinim me njëra-tjetrën mund të shërbejnë mjaft mirë për të trajtuar problematikat e përbashkëta në mënyrë që burimet në dispozicion të mund të përdoren me sa më tepër efikasitet.

Në të njëjtën kohë, ky seksion përmban përfundime dhe vëzhgime të mbledhura nga përvojat dhe referencat e vëzhgimeve të *VIS Albania*, gjatë periudhës së angazhimit si pikë koordinimi për rajonin veriperëndimor dhe falë pranisë së saj të konsoliduar në territor që prej vitit 2009.

Në **nivel projekti** dhe pozicionimi të OSHC-ve lokale të rajonit në fjalë, projekti ka nxjerrë në pah mungesën e madhe të kapitalit njerëzor dhe profesional të rajonit, i pasqyruar edhe nga heterogjeniteti i përvojave të organizatave lokale (jo vetëm atyre përfituese nga projekti). Krahas kësaj, në rajon, ekziston tashmë një bazë e rëndësishme bashkëpunimi dhe njohjeje reciproke midis shoqatave të pranishme, gjë që sigurisht kontribuoi në përfundimet e mëposhtme:

- Angazhimi i OSHC-ve lokale rezultoi i suksesshëm pasi ato njohin kontekstin dhe territorin, kuptojnë nevojat, e dinë se cilat janë praktikat më të mira në përjasjen me komunitetet lokale dhe sigurohen që përfituesit direkt të jenë pikërisht këto komunitete. Angazhimi i tyre nxiti partneritetet dhe marrëdhëniet me grupet e interesit në komunitete dhe me organizata të tjera.
- Fuqizimi i komuniteteve lokale për të ruajtur mjedisin e për të promovuar pikat e turistike është një mënyrë efektive për përmirësimin socio-ekonomik në zonë.



- Ndërtimi i lidhjeve me institucionet vendore, shkollat dhe OSHC-të lokale që kanë në fokus mjedisin është mënyra më e shpejtë e ndërgjegjësimit të komuniteteve lokale për rëndësinë që ka mjedisi për jetën e tyre.
- Përfshirja e të rinjve në mënyra aktive dhe novatore (si qyteti ekologjik dhe mbetjet ushqimore) është jo vetëm thelbësore për qëndrueshmërinë, por edhe shumë efektive në aspektin e advokimit në nivel lokal e më gjerë dhe për të marrë ide novatore për zbatim në komunitet. Për këtë, është e domosdoshme përfshirja e temave mjedisore (njohja e mjedisit, mbrojtja e tij, praktikat e zhvillimit të qëndrueshëm), duke i bërë ato pjesë integrale e programeve mësimore në shkolla të arsimit parauniversitar dhe pjesë e kurikulave universitare në të gjitha fushat.

Në **nivel mjedisor**, projektet përfituese të Green-AL theksuan 3 prioritete tematike për rajonin dhe shprehën zgjidhjet e mundshme, me disa prioritete veprimi që duhen mbajtur parasysh në periudhën afatshkurtër dhe afatmesme:

### **(A) MENAXHIMI I MBETJEVE**

- Pikat e grumbullimit duhet të mirëmenaxhohen (pika e grumbullimit Bushat), por edhe të rikonceptohen (pika e grumbullimit në fshatin Pjetrosan dhe derdhjen në Përroin e Thatë).
- Tkurra e popullsisë në qarkun Shkodër e Lezhë ka vite që ndodh, gjë që identifikon një nevojë të menjëhershme për përcaktimin e strategjive për frenimin e kësaj prirje tkurjeje.
- Organizimi i fushatave të pastrimit ishte një mënyrë e mirë jo vetëm për pastrimin e përmirësimin e ekosistemit, por edhe për përfshirjen e komunitetit lokal dhe për të treguar praktika të mira (edukim nëpërmjet veprimit).
- Secili nga projektet nxori në pah se parandalimi është shumë më mirë se evidentimi:
  - parandalimi i hedhjes së mbeturinave në terren (prezenca e koshave për ndarjen e mbeturinave),
  - parandalimi i braktisjes së rrjetave në liqen (peshkatarët e vlerësuan se rrjetat e braktisura nga vetë ata ishin një rrezik për jetën e punën e tyre),
  - parandalimi i humbjeve ushqimore (nëpërmjet dhurimit të ushqimit të tepërt të njerëzimit në nevojë – kjo mund të shërbejë mjaft mirë edhe si një model biznesi),
  - riciklimi i mbeturinave (banorët e fshatrave mund t'i kthehen mjaft mirë praktikave të harruara përmes kompostimit).

### **(B) MENAXHIMI I KAPITALIT NATYROR** (me vëmendje të veçantë në liqenin e Shkodrës)

- Zhvillimi i turizmit është një burim i rëndësishëm ekonomik për komunitetet lokale. Megjithatë, duhet patjetër të kemi parasysh të mbrojtjen e burimeve natyrore (të mos shfrytëzohen burimet natyrore për përfitime afatshkurtra). Kjo arrihet vetëm nëpërmjet investimit në komunitetet lokale dhe angazhimit të grupeve lokale të interesit në vendimmarrje.

- Universiteti i Shkodrës "Luigj Gurakuqi" duhet të luajë një rol më domethënës për promovimin e zhvillimit të qëndrueshëm nëpërmjet përfshirjes së këtij elementi kaq të rëndësishëm në më tepër programe studimi e te nxitja e kërkimit shkencor për gjetje të qëndrueshme të problematikave në komunitetet lokale.
- Institucionet publike vendore duhet të përfshijnë temat e qëndrueshmërisë në mënyrë më aktive në politikat e praktikat e tyre, të angazhojnë komunitetet lokale nëpërmjet informimit e ndërgjegjësimit, të sigurojnë e të mbështesin mbrojtjen e burimeve natyrore apo të mbështesin e të promovojnë bizneset lokale që aplikojnë praktika të qëndrueshme.
- Është thelbësore të punohet për një shtrirje dhe standardizim të përgjithshëm të sinjalistikës turistike dhe informacionit në lidhje me vendet me interes të veçantë, si të lidhura me liqenin ashtu edhe me zonat lagunore dhe malore, duke rritur gjithashtu sinjalistikën dhe investimet për përmirësimin dhe vlerësimin e burimeve natyrore në zonat e mbrojtura (kryesisht Liqeni i Shkodrës).
- Në nivel kombëtar, strategjia e AKZM-së në menaxhimin e kapitalit natyror dhe në transferimin e këtij koncepti dhe të të drejtave dhe detyrave që rrjedhin prej tij tek popullatat që jetojnë dhe punojnë në këto zona është ende e paqartë (p.sh. mungesa e qartësisë në lidhje me lejet e ndërtimit në zonat e mbrojtura, ku në disa raste ato jepen pa ndjekur procedurën klasike të bashkisë por me delegim direkt tek Kryeministri).
- Nevoja për të mobilizuar një grup aktorësh në drejtim të menaxhimit të Liqenit të Shkodrës (zona tokësore dhe ujore) për të mbrojtur mjedisin, por edhe të peshkatarëve të vegjël dhe në një koordinim më të madh të detyrave ndërmjet OMP-së, Inspektoratit të Peshkimit dhe AKZM-së, duke parë gjithashtu dy probleme kryesore të ndeshura: mbetjet dhe rrjetat në shtratin e liqenit dhe peshkimi i paligjshëm. Në këtë rast, bashkëpunimi dhe dialogu mes dy ministrive të ndryshme është thelbësor: si ajo e Mjedisit dhe Turizmit ashtu edhe ajo e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural. E njëjta situatë duhet nënvizuar edhe në zona të tjera që janë të rëndësishme për kapitalin natyror të territorit, si gështenja e Reçit apo mali i Taraboshit.

### **(C) PLANE DHE INVESTIME MIQËSORE ME MJEDISIN**

- Nga anketimi i 1,029 qytetarëve u dallua nevoja për hartimin dhe monitorimin e indikatorëve lokalë për arritjen e standardeve ekologjike në nivel urban.
- Është konstatuar se bashkia Shkodër nuk ka një plan lokal veprimi, i cili vendos kritere për arritjen e objektivave për të qenë një Qytet Ekologjik dhe prandaj është e nevojshme në një kohë të shkurtër hartimi dhe monitorimi i indikatorëve lokalë për arritjen e standardeve ekologjike dhe hartimi i një plani veprimi për zbatimin e masave, kritereve dhe aktiviteteve drejt një Qyteti Ekologjik në bashkinë Shkodër, me ambicien për të përkthyer të njëjtën qasje edhe në zona të tjera urbane si Lezha dhe Malësia e Madhe.
- Një mbështetje dhe përfshirje më e madhe nga ana e sektorit privat e kuptuar si edukim i komuniteteve lokale për zhvillimin e qëndrueshëm duke gjetur modele biznesi që të sjellin jo vetëm përfitime ekonomike për vetë biznesin, por edhe të

përmirësojnë jetën socio-ekonomike të gjithë komunitetit, ashtu edhe duke mobilizuar të njëjtat biznese për veprime pro-aktive të mbrojtjes dhe qëndrueshmërisë së mjedisit, të pavarura nga institucionet publike.

Për sa i përket të dhënave që lidhen me **barazinë gjinore** dhe pranisë së grave e vajzave në sferën mjedisore, rajoni veriperëndimor paraqet disa konsiderata specifike.

- Në totalin e 4 projekteve të zbatuara në periudhën 2021 – 2022, ekziston një balancë në përfshirjen e aktorëve të ndryshëm për sa i përket përfaqësisë gjinore (shih grafikun 1), megjithëse vërehet se djemtë/burrat janë në numër më të madh. Në këtë pikë, megjithatë, duhet të kihet parasysh se një nga projektet kishte grup të synuar një komunitet të mbizotëruar nga burrat, atë të peshkatarëve, të përfshirë si individë dhe jo si familje. Megjithatë, kjo nxjerr në pah se si përfshirja e grave në fusha që nuk janë drejtpërdrejt sociale konsiderohet ende dytësore ndaj përfshirjes së burrave.
- Megjithatë, nëse vlerësimi do të shprehej duke marrë parasysh përfshirjen e grupmoshave më të reja dhe shkollave në veçanti, proporcioni ndryshon në favor të pjesëmarrjes së grave. Në fakt, gjatë aktiviteteve të aktivizimit dhe angazhimit, vajzat u treguan më pro-aktive dhe të guximshme për t'u ekspozuar me ide novatore dhe komplekse, si në konkursin "Panairi i Ideve-Qyteti im Ekologjik" (shih faqen 60), duke treguar një prirje më të madhe për aktivizim dhe angazhim qytetar.
- Nga ana tjetër, për sa i përket përbërjes së roleve drejtuese në nivel të OSHC-ve mjedisore përfituese, situata duket të jetë inkurajuese: 2 nga 4 shoqatat kanë gra në role përfaqësuese/drejtuese ligjore dhe për më tepër me garanci më të mëdha qëndrueshmërie dhe vazhdimësie nëse kemi parasysh komponentin e të dhënave personale (mosha e menaxherit/përfaqësuesit ligjor).

Edhe pse të vetëdijshëm se kampioni i paraqitur është me numër të reduktuar, ai duket të jetë i rëndësishëm për zonën, duke konsoliduar nevojën e shprehur tashmë për të përfshirë brezat e rinj në mënyrë më sistematike dhe më të sigurt, të vetëdijshëm se do të kontribuojnë për një përfshirje më të mirë dhe më efektive gjinore.

## REFERENCA

- AKZM. (2023). Zonat e Mbrojtura. Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura. <https://akzm.gov.al/zonat-e-mbrojtura/>
- Dhora, D., Dhora, D., & Dhora, A. (2016). *Ref-id-8188.pdf*. <http://www.animalbase.uni-goettingen.de/digiref/ref-id-8188.pdf>
- EEA. (2021). *Food Waste Albania—Google Search*. [https://www.google.com/search?q=food+waste+albania&rlz=1C1SQJL\\_enAL957AL957&biw=1536&bih=714&ei=UGYcZO3gHaaVxc8PpMaVKAU&ved=0ahUKewjtyMbBpfL9AhWmSvEDHSRjBVIQ4dUDCA8&uact=5&oq=food+waste+albania&gs\\_lcp=Cgxnd3Mtd2l6LXNlc\\_nAQAzIGCAAQFhAeOg4lLhDHARDRAxCRAhDqBDolCAAQsQMqgwEQkQl6EAgUEIMBEMcBELEDENEDEEM6CwgAEIAEELEDEIMBOgUIABCABDoLCAAQsQMqgwE6BQgAEJECOGQIABBDQsILhCABBCxAxCDAToLCC4QgAQQsQMqQ1Al6CAgAEIAEELEDOg4lLhCABBCxAxDHARDRAzoLCAAQgAQQyQM6BwgAEIAEEAo6BQguEIAEOgclABANEIAEOgYIABAE06CAgAEB4QDRAKOgglABAE0AQDzoLCAAQFhAeEA86BQgAEIYDSgQlQRgBUMQbWJxxYNOAAWglcAB4AIABnQKIAcofkgEGMC4yMS4zmAEAoAEBsAEAwAEB&sclient=gws-wiz-serp](https://www.google.com/search?q=food+waste+albania&rlz=1C1SQJL_enAL957AL957&biw=1536&bih=714&ei=UGYcZO3gHaaVxc8PpMaVKAU&ved=0ahUKewjtyMbBpfL9AhWmSvEDHSRjBVIQ4dUDCA8&uact=5&oq=food+waste+albania&gs_lcp=Cgxnd3Mtd2l6LXNlc_nAQAzIGCAAQFhAeOg4lLhDHARDRAxCRAhDqBDolCAAQsQMqgwEQkQl6EAgUEIMBEMcBELEDENEDEEM6CwgAEIAEELEDEIMBOgUIABCABDoLCAAQsQMqgwE6BQgAEJECOGQIABBDQsILhCABBCxAxCDAToLCC4QgAQQsQMqQ1Al6CAgAEIAEELEDOg4lLhCABBCxAxDHARDRAzoLCAAQgAQQyQM6BwgAEIAEEAo6BQguEIAEOgclABANEIAEOgYIABAE06CAgAEB4QDRAKOgglABAE0AQDzoLCAAQFhAeEA86BQgAEIYDSgQlQRgBUMQbWJxxYNOAAWglcAB4AIABnQKIAcofkgEGMC4yMS4zmAEAoAEBsAEAwAEB&sclient=gws-wiz-serp)
- Environment, U. N. (2021). *UNEP Food Waste Index Report 2021*. UNEP-UN Environment Programme. <http://www.unep.org/resources/report/unep-food-waste-index-report-2021>
- *FAO - News Article: Food wastage: Key facts and Figuras*. (n.d.). Retrieved March 23, 2023, from <https://www.fao.org/news/story/en/item/196402/icode/>
- *Food loss and waste*. (n.d.). Food and Agriculture Organization of the United Nations. Retrieved March 23, 2023. From <http://www.fao.org/nutrition/capacity-development/food-loss-and-waste/en/>
- INSTAT. (2021). *Vjetari Rajonal Statistikor 2021*. <https://www.instat.gov.al/al/publikime/librat/2021/vjetari-rajonat-statistikor-2021/>
- INSTAT. (2022). *Vjetari Rajonal Statistikor 2022*. <https://www.instat.gov.al/al/publikime/librat/2022/vjetari-rajonat-statistikor-2022/>
- Njesitë Administrative. (n.d.). *Porta Vendore*. Retrieved March 21, 2023, from: <https://portavendore.al/bashkia-malesi-e-madhe/pasaporta-e-bashkise-malesi-e-madhe/njesite-administrative/>
- Papunësia. (2021). *Punësimi dhe papunësia*. <https://www.instat.gov.al/al/temat/tregu-i-pun%C3%25ABs-dhe-arsimi/pun%C3%25ABsimi-dhe-papun%C3%25ABsia/>
- Planifikimi. (2020). *Dokumenti i Politikave Strategjike dhe Plani Kombëtar i Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve, 2020–2035*.

- Qarku Shkodër. (2020). *Tendencat e Zhvillimit të Turizmit në Shkodër, Këshilli i Qarkut Shkodër*.  
<https://qarkushkoder.gov.al/tendencat-e-zhvillimit-t-e-turizmit-ne-shkoder/>
- Shkodër, K. I. Q. (2014, September 1). *Zonat e mbrojtura, Këshilli i Qarkut Shkodër*.  
<https://qarkushkoder.gov.al/zonat-e-mbrojtura/>
- Waste. (2013). *Foodwastage footprint: Impacts on natural resources: summary report*. FAO.
- Plani i Përgjithshëm Vendor, Bashkia Malësi e Madhe, 2017.
- Konsultuar me materiale të prodhuara nga VIS dhe Kallipolis në kuadër të projektit LILA “*Designing and implementing a livable and sustainable strategy for the development of Shkodra Lake through the involvement of the local community (2021-2023)*”, bashkëfinancuar nga Rajoni Autonom Friuli Venezia Giulia.
- Konsultuar me materiale të prodhuara nga VIS në kuadër të projektit “NaturAlbania”(2020 – 2023), të financuar nga AICS – Agjencia Italiane e Bashkëpunimit për Zhvillim.

## ANEKS

### PËRMBLEDHJE E INFORMACIONEVE PËR SHOQATAT QË KANË ZBATUAR PROJEKTET

#### 1. SHOQATA BLINI

Shoqata "Blini" është themeluar në 2006, e njohur me vendim nr. 1163 datë 20.03.2006 dhe operon në Malësi të Madhe, me vëmendje të veçantë në njësinë administrative Kastrat. Qëllimi kryesor i aktivitetit të shoqatës "Blini" është vlerësimi dhe menaxhimi i pyjeve e kullotave, si edhe ruajtja e mjedisit dhe administrimi i ujërave.

Përgjatë këtyre viteve kjo shoqatë ka zbatuar disa projekte, në kuadër të të cilave në Malësi të Madhe janë zhvilluar aktivitete të ndryshme. Me qëllim ndërgjegjësimit e komunitetit për mbrojtjen e pyjeve dhe mjedisit, janë bërë investime për përmirësimin e sipërfaqeve pyjore të zonës së Kastratit dhe Bajzës nëpërmjet nismave të shumta të ripyllëzimit dhe janë ndërtuar lera uji për blegtorinë, duke qenë se kjo zonë vuan nga mungesa e burimeve ujore.

Shoqata "Blini" ka dhënë mbështetje në zhvillimin rural të qëndrueshëm në këtë territor nëpërmjet mbështetjes së bujqësisë dhe pastrimit e mirëmbajtjes së kullotave. Gjithashtu, vëmendje kanë pasur edhe nismat për mbrojtjen e mjedisit dhe promovimin e vlerave natyrore të Malësisë së Madhe, veçanërisht të zonës së Kastratit.

Fushatat edukuese të pastrimit të mbetjeve në bashkëpunim me shkollat 9-vjeçare dhe të mesme të zonës së Kastratit kanë qenë vazhdimisht pjesë e aktivitetit të shoqatës "Blini".

Përveç sa më sipër, shoqata ka zhvilluar edhe takime e trajnime për vlerësimin dhe mbrojtjen e pyjeve dhe mjedisit, dhe promovimin e tyre në shkolla e grupe rinore që janë aktive në territor, në mënyrë që këto vlera të transmetohen edhe te brezat me të rinj.

Shoqata "Blini" ka menaxhuar projekte të financuara nga donatorë të ndryshëm, si: REC Albania, Banka Botërore, Ministria e Mjedisit, AZHBR, Qeveria Suedeze, etj.

Adresa: Kastrat, Malësi e Madhe, Shqipëri

Kontakt: +355 67 6941523

Facebook: <https://www.facebook.com/shoqatablini>

#### 2. ORGANIZATA E MENAXHIMIT TË PESHKIMIT (OMP) LIQENI I SHKODRËS

OMP-ja e Liqenit të Shkodrës është formuar me 05.05.2003 dhe regjistruar në regjistrin themeltar me datë 14.09.2010 me nr. protokollit 2916. Që nga dita e themelimit OMP-ja ka pasur një bashkëpunim të ngushtë me ministrinë e linjës, ku ka lidhur dhe kontrata për

zhvillimin e aktivitetit të peshkimit ne zonat bashkë-menaxhuese për peshkim: kontrata nr. 6042 datë 02.08.2016 dhe zonë bashkë-menaxhuese për peshkim VKM nr. 469 datë 22.06.2016. Me këtë bazë ligjore OMP zhvillon aktivitetin në zonën e Liqenit te Shkodrës dhe lumit të Bunës në fushën e menaxhimit te peshkimit dhe ruajtjen e resurseve peshkore.

Adresa: Qendra e Peshkimit, Shirokë, Shqipëri

Kontakt: +355 67 3065541

E-mail: [info@omp-al.com](mailto:info@omp-al.com)

Facebook: <https://www.facebook.com/omp.omp.3>

### 3. WELL-POINT – KUJDES PËR TË GJITHË

Shoqata *Well-Point* është një shoqatë e re e cila është themeluar në 30 Janar 2015 me vendim nr. 4088 të Gjykatës së Rrethit Tiranë. Edhe pse ka 8 vite që është themeluar, ka një veprimtari shumë aktive.

Në këto vite, *Well-Point* ka bashkëpunuar me shoqata mjedisore dhe institucione shtetërore për tema të mbrojtjes së mjedisit dhe shëndetit publik, meqë dhe fokusi i saj është ruajtja e shëndetit publik dhe mjedisor.

Me bashkinë Shkodër dhe ADZM Shkodër, shoqata ka një marrëveshje bashkëpunimi të nënshkruar qysh në vitin 2020 dhe bashkëpunon ngushtësisht pothuajse në çdo aktivitet që ka qëllim mbrojtjen dhe promovimin e natyrës apo zonave të mbrojtura. Përmes ekspertëve të saj shoqata angazhohet në promovimin dhe mbrojtjen e burimeve natyrore, ndërmarrjen e veprimeve konkrete me synim zhvillimin e turizmit mjedisor, të qëndrueshëm në Liqenin e Shkodrës dhe lumin Buna.

Falë bashkëpunimeve dhe partneriteteve me institucione shtetërore, shoqata mjedisore dhe shkolla, përmes angazhimit qytetar me përfshirjen e të rinjve dhe aktivistëve, aktivitete të shumta janë realizuar duke ndërmarrë fushata ndërgjegjësuese, pjesëmarrje në konkurse idesh të gjelbra, sesione trajnimi dhe informimi, edukim mjedisor, aktivitete pastrimi.

Çdo janar në bashkëpunim me AdZM Shkodër dhe shoqata të tjera merr pjesë në Censusin ndërkombëtar të shpendëve, duke përfshirë edhe grupin e të rinjve "Natyralistët".

Adresa: Lagja Vasil Shanto, Bulevardi "Marin Barleti", pallati pas kinema Millenium, Shkodër, Shqipëri

E-mail: [wellpointassociation@gmail.com](mailto:wellpointassociation@gmail.com)

Kontakt: +355 67 4060132

Webpage: [WellPoint Albania \(wordpress.com\)](http://WellPointAlbania.wordpress.com)

Facebook: <https://www.facebook.com/wellpointalbania/>

Instagram: <https://www.instagram.com/wellpoint.assc/>

#### 4. FORUMI SHQIPTAR LIQENI I SHKODRËS (FSLs)

FORUMI Shqiptar Liqeni i Shkodrës është organizatë e shoqërisë civile, e themeluar në 2001 në kuadër të programit REReP 04.03.23 përmes mbështetjes financiare të SDC me fokus mbrojtjen e natyrës dhe e regjistruar në 2008 me vendim nr. 2192, datë 26.02.2008.

Organizata ka mision të kontribuojë në qëndrueshmëri dhe transparencë për përdorimin e burimeve natyrore, duke zbatuar projekte që ndërtojnë qëndrueshmëri në ruajtjen e natyrës, që promovojnë dhe adresojnë zgjidhje, që nxisin nisma dhe zhvillojnë kapacitete për qeverisjen mjedisore në nivel lokal, kombëtar dhe ndërkufitar. Përmes shkëmbimit të lirë të informacionit, Forumi synon pjesëmarrjen publike në vendimmarrje mjedisore dhe rritjen e vetëdijes qytetare në vendimmarrje.

Organizata zotëron kapacitete njerëzore, burime të përgjegjshme, të dhëna mjedisore, si dhe kapacitete të plota administrative. Me një eksperiencë të gjatë në fushën e mbrojtjes së mjedisit, Forumi Shqiptar Liqeni i Shkodrës ka ndërmarrë dhe zbatuar dhjetëra projekte të qëndrueshme në nivel rajonal, lokal, kombëtar e ndërkufitar.

Adresa: Sheshi 2 Prilli, Rruga "Beroviq", Nr. 21, Shkodër, Shqipëri

Tel/Fax: +355 (0) 22241877

Email: [transboundary.forum@gmail.com](mailto:transboundary.forum@gmail.com)

Webpage: <http://shkodralake.org>

Facebook: <https://www.facebook.com/forumi.liqeni>

Instagram: <https://www.instagram.com/forumiliqenishkodres/>

LinkedIn: <https://www.linkedin.com/lake.forum>

Twitter: <https://twitter.com/ForumLiqeni1>





© VIS Albania, 2023

*Ky material është pronësi intelektuale e  
VIS Albania, Volontariato Internazionale  
per lo Sviluppo*

